

PËR MËSËN/EN



Nazlije Cakolli, Naime Bunjaku

EDUKATË MUZIKORE

Për klasën e katërt të arsimit fillor

4

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes	5
Hyrje	7
Planifikimi vjetor.....	15
Plani dymujor: shtator—tetor.....	16
Plani dymujor: nëntor—dhjetor	19
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	23
Plani tremujor: prill—maj—qershor	27
Mësimi 1: Të këndojojmë: "Shtatori"	32
Mësimi 2: Bota e tingujve	34
Mësimi 3: Të mësojmë të këndojojmë - solisti/ja dhe kori	36
Mësimi 4: Të këndojojmë: "Katër stinët e vitit"	38
Mësimi 5: Pentagrami	40
Mësimi 6: Nota <i>Sol</i>	42
Mësimi 7: Të dëgjojmë: Edvard Grieg, "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt).....	44
Mësimi 8: Format muzikore: A B A.....	46
Mësimi 9: Melodia dhe ritmi.....	48
Mësimi 10: Piktura dhe muzika.....	50
Mësimi 11: Masa 2/4.....	52
Mësimi 12: Të këndojojmë: "Himni i Flamurit"	54
Mësimi 13; Vlerat e notave: nota katërshe dhe nota tetëshe	56
Mësimi 14: Të dëgjojmë: Camille Saint-Saëns, "Aviary" (nga "Karnaval i kafshëve")	58
Mësimi 15: Gjej dhe emërtó instrumente	60
Mësimi 16: Të këndojojmë: "Viti i Ri"	62
Mësimi 17: Didaktike: "Dordoleci" - nota <i>Do</i>	64
Mësimi 18: Kitara	66
Mësimi 19: Notat <i>La</i> dhe <i>Si</i>	68
Mësimi 20: Lahuta - të dëgjojmë: Drinor Zymberi, "Epos"	70
Mësimi 21: Notat <i>Fa</i> dhe <i>Re</i>	72
Mësimi 22: Të këndojojmë: "Vendi im"	74
Mësimi 23: Të këndojojmë: "Fëmijët e Kosovës"	76
Mësimi 24: Të këndojojmë: "Mami, mami"	78
Mësimi 25: Muzika jonë popullore: "Pranvera filloi me ardhë"	80
Mësimi 26: Të këndojojmë: "Prilli piktor"	82
Mësimi 27: Profesionet	84
Mësimi 28: Të këndojojmë: "Bicikleta".....	86
Mësimi 29: Të dëgjojmë: "Simfonia e 5-të e L.V. Beethoven-it"	88
Mësimi 30: Muzeu, teatri, sala koncertale dhe galeria	90
Mësimi 31: Llojet e muzikës.....	92
Mësimi 32: Të këndojojmë: "Kënga e planetëve".....	94
Mësimi 33: Të dëgjojmë: Fahri Begiri dhe Vinçenc Gjini, Giora Feldman "Let's be happy"....	96
Mësimi 34: Kanoni.....	98

Mësimi 35: Lojë ritmike	100
Mësimi 36: Të ndërtojmë instrumente.....	102
Mësimi 37: Të këndojmë: "Lamtumirë"	104

Të dashur mësues dhe mësuese,

Ky libër është hartuar me qëllimin për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitet më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuuar në shoqëri. Për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese “Dukagjini” aplikon metodologji bashkëkohore të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, që ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: *Çfarë metodologje do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Republikës së Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?*

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjera, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënënit, futjen e veprimitarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehi të të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbrushur kërkuesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e të nxënënit dhe e mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por nga ju kërkohet edhe të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen maksimalisht në mësim.

Modeli i këtyre librave dhe mësimet janë hartuar me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRËFYES

për konceptimin e mësimeve model

Faqja në të majtë

Këto janë të dhëna identifikuuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxenit, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.

Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxenit.

Parashikimi është fazë e parë e orës mësimore që siguron përgjendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.

Mësimi 1

ASPEKTE TE PERGJITHSHME TE PLANIT TE ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare Art Lënde Edukative Shkolla e mesme Klasa IV Teme Kongjtë

Burimet e të mësuarit si mësim. Këndet e interpretimit ne instrument (individalist shi një grup) apo imitim e do te mësimi. Shqipçen këndimet me së...

Kontributi te rezultave te kompetencat kryesore te shkollës I, II, III A/V2

Kontributi te rezultave e fushas si kurrikullore 1,1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TE PLANIT TE ORËS MËSIMORE

Njësi mësimore: Të klasifikohen "Shator".

Rezultatet e të mësuarit te orës mësimore:

- Këndet e interpretimit ne instrument
- Interpretimi i mësimorëve
- Plotëson skenën e bazave ne pyjet e pyrrazhura.

Kriteret e suksesit Fisak

Burimi, mjetet e konkretizimit dhe materiali te mësimave projekt: laptop, skema si flet A4, CD me...

Lidhje me fletën e parë mësimore shqipçen e shkollës së parë. Njësi e parë. Njësi e dytë. Njësi e tretë. Njësi e quajtur mësim.

METOLOGIA E PERPUTHSHME ME NXENËS

Parashikimi

Rezultatet e të mësuarit te orës mësimore

Mësimi te parë përmes projektave domino e njoftuesme. Burimi i veshut akademik "Shator". Detyrë e nxënësve është që të kregjoi se cilat bëjnë fëmijët me i shkurt. Mendimi e tyre këndohet si skenë e njoftuesme. Sëçilt mësimi na mësuroj individualisht i përpjekshet e mësja skenë, të cilën kund përditësh që i përfundoj. Vazhdui projekti me qëndra projekte.

Parashikimi

Njësimi i njohurive dhe i shkaktave: Përpunimi i përbajtjes

Diqigjet këngë me mësim. Par qëdo shkak, mësimdhënës u detyroj të përgjendej përmes këngës së kingut. Data i lidhës CD-i me studi e park. Data këngës e plotë e bllokuar si bashe. Që ju përgjigjet se shumë e këtë king? Për...

Përfaqësimi: Konsolidimi dhe zhvillimi i të mësuarit

Mësimi te parë përmes projektave skenë e njoftuesme. Detyrë e nxënësve është që ta pëtjohoj atë. Vazhdui projekti kohës, dia proj. tyre leshon.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për rastësinë e përgjigjeve dhe mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë: Ni portafoli i pënpotit këqin me notat muzikore.

Refleksion:

Refleksion për organizimin e orës mësimore.

Rezultatet:

Paraqitura e faqes së librit të nxënësít ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Rezultatet e të nxenit të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjërë.

Rezultatet specifike të të nxenit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zberthim i rezultateve të të nxenit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësít në klasë.

Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentoohen.

Faqja në të djathtë

Paraqitura e faqes së librit të nxënësít ndihmon mësuesin gjatë përgatitjes.

Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxenit.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.

Shator

Njësimi i njohurive dhe i shkaktave: Përpunimi i përbajtjes

Diqigjet këngë me mësim. Par qëdo shkak, mësimdhënës u detyroj të përgjendej përmes këngës së kingut. Data i lidhës CD-i me studi e park. Data këngës e plotë e bllokuar si bashe. Që ju përgjigjet se shumë e këtë king? Për...

Përfaqësimi: Konsolidimi dhe zhvillimi i të mësuarit

Mësimi te parë përmes projektave skenë e njoftuesme. Detyrë e nxënësve është që ta pëtjohoj atë. Vazhdui projekti kohës, dia proj. tyre leshon.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për rastësinë e përgjigjeve dhe mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë: Ni portafoli i pënpotit këqin me notat muzikore.

Refleksion:

Refleksion për organizimin e orës mësimore.

Rezultatet:

Përpunimi i përbajtjes është fazë e dyte e orës mësimore, ku bëhet përgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik të tij.

Përforcimi është fazë e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe shprehive, si dhe zbatimi i tyre.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

Rezultatet e të nxenit të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përgjedhjen e përbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxenit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy o më shumë rezultate. Një rezultat i të nxenit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxenit dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësish në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënët. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitet, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënët të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënët: Rezultatet specifike të të nxënët janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimit, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënët të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zërthim i rezultateve të të nxënët sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës: Ora mësimore shtrihet në tri fazë kryesore: parashikimi (përgatitja për të nxënët), ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive (përpunimi i përbajtjes), përforcimi (konsolidimi i të nxënët).

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimit?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënëjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



Parashikimi: Përgatitja për të nxënët

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është fazë e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të nxënët, kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj ç'ka di rreth temës së mësimit, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përbajtjes

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënëjë dhe bima rritet. Kjo është fazë e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënët dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfitimit të kuptimit të njohurive, gjithashtu ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënët e ri dhe ristrukturojnë skemën e tyre për t'i përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

EDUKATË MUZIKORE 4

Kontaktet e para me muzikën fëmija i merr që në moshë të hershme, fillimisht në rrethin familjar e pastaj edhe përmes edukimit muzikor në institucione parashkollore. Ata vazhdimisht këndojnë, dëgjojnë muzikë në rrethin ku jetojnë, dëgjojnë zërat në natyrë, onomatopetë e ndryshme ritmike dhe melodike etj. Këto përvoja të hershme mund të përdoren për edukimin muzikor në shkollimin fillor, duke i konkretyzuar këto përfundime nga jeta e përditshme me lojëra, këngë, ligjërimë ritmike, lëvizje etj.

Përmes aktivitetit muzikor, te fëmijët sjellim gjësim, hare, relaksim, entuziazëm dhe në këtë mënyrë muzika ndikon direkt në pasurimin emocional të tyre, i fisnikeron ata dhe njëkohësisht ndikojmë në zhvillimin e dispozitive të ndonjë prej aftësive muzikore për të cilën ata mund të kenë predispozitë.

Udhëzime metodologjike

Për zbatim praktik të planifikimit mësimor për artet, brenda orës mësimore dhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtekurrikulare, nevojitet përdorim i përshtatshëm i metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënësit.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësit

Libri që keni në duar është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulen Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës" (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësit të fushës, rezultatet specifike të të nxënësit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecurinë metodologjike të orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve.

Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrike: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mban shënimë për punën tuaj në klasë, arritet, si dhe rastet kur nuk mund t'i arrini ato, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas. Suksesi i nxënësve arrihet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësit. Kjo arrihet duke përdorur qasje krijuese, ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore, si dhe duke përdorur metoda, teknika e forma të shumëlojshme të punës.


Përbajtja tematike korrespondon me temat që trajtohen nga fushat e tjera mësimore, por edhe me çështjet e ndryshme ndërkurrikulare. Gjatë këndimit nxënësi aplikon qëndrim të drejtë, këndim me emocion, shqiptim të saktë të tekstit, këndon në intonacion sa më të saktë. Fëmijët inkurajohen të këndojnë vetëm, por edhe në grup, të krijojnë efekte të veçanta tinguish (imitimin e zërave të shkokëve, të instrumenteve të ndryshme etj.), duke përdorur zërin, shkopinjtë, shuplakat ose instrumentet, të ndjekin ndryshimet e ritmit etj.

Puna me instrumentet muzikore shton interesin për aktivitetet muzikore si dhe ndihmon drejt në edukimin e ndjenjës ritmike apo melodike.

Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet së cilës fëmija vihet në marrëdhënie me muzikën. Përmes dëgjimit ata shprehin emocione që sjell kënga, vepra instrumentale etj.

Mësuesi duhet të kultivojë ndjenjën e të dëgjuarit të zërit të tij përderisa fëmija këndon këngën, të shoqërojë muzikën me lëvizje të përshtatshme.

Në aspektin e ndërlidhjes dhe të integrimit, muzika mund të jetë pjesë e çdo teme të realizuar nga fusha të ndryshme. Psh., në matematikë, krahasimi i thyesave me ndarjen e njësisë për numër (nota katërshe, gjysmë, tetëshe); dukuritë e ndryshme muzikore në shkencat e natyrës (si prodhohet zëri, si përçohet zëri etj.); ushtrimet gjatë orëve të edukatës fizike, sportet dhe shëndeti (ecja, vrapit, aktivitetet e ndryshme) mund të shoqërohen me muzikë ritmike. Pra, në çdo temë apo njësi mund të inkuadrohet muzika përmes dëgjimit ose këndimit për të bëre mësimin më interesant për fëmijët e kësaj moshe. Muzika është mjet i mirë për relaksim gjatë pushimeve të shkurtra. Muzika relaksuese dhe e qetë i qetëson nxënësit dhe ndikon që të jenë të përgatitur për mësimin e radhës. Shumë aktivitete rutinë mund të sinjalizohen përmes këngëve të ndryshme ose shembujve adekuatë muzikorë për dëgjim.




Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes së mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënëtit e të çdo veprimtarie tjeter, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjeter, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas

Zgjeroni dhe thelloni dijet
Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)
Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e Zhvillimit Proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga

mësuesi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Sipas Piazhesë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgim. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi në mënyrë sistematike i tyre, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit të nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsyesh, mësimet janë të strukturuara në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar jepin ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe krijimin e dijeve, si dhe formimin e shprehive.



Zgjeroni dhe thelloni
dijet

Për më shumë lexoni
në: Woolfolk. A. (2011)
Psikologji edukimi. Tiranë: CDE,
faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës 2

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo jolettar, të palexuar më parë.
2.	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3.	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4.	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njëren nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5.	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, këngë apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7.	Shpreh, në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi në gjuhë të huaj, të dhëna si detyrë.
8.	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informacioneve të tjera.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërsë nga format shprehëse.
2.	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3.	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4.	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5.	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imaginatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6.	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, historiko-shoqërore) në njëren nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mëjedisin që e rrithen e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7.	Paraqet dhe arsyeton me argumete mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8.	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, veticë, shndërrimeve apo pozitave në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimit) të tyre.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

1.	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërs nga format e shprehjes.
2.	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3.	Identifikon dhe krahason informatat e njoitura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
4.	Ndjeq udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5.	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6.	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigimeve të nevojshme.
7.	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8.	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9.	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

1.	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet përfusha të caktuara, duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.
2.	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përgjedhjen e tyre.
3.	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre etj.
4.	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme përmirësimin e gjendjes.
5.	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë/laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6.	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë; të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
7.	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo përrreziqet në rast mospërdorimi të drejtë (adequat).
8.	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë genjeje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të saj.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
1.	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjenës personale (fizike, të veshmbathjesh, të gjësendeve personale) dhe të higjenës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike/lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3.	Përgatit një listë (me njëren nga format e shprehjes: shkrim, vizatim etj.) me ushqime të cilat i konsumon familja, duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4.	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5.	Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6.	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Dallon dhe përkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8.	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
9.	Përkujdeset për mjesid të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrrehojnë etj.).

VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
1.	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.
2.	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
3.	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.
4.	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5.	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6.	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërs rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7.	Identifikon dy e më shumë organizime shoqërore dhe përkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjeter) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8.	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrëthit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet - mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9.	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast reziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërsimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET - Shkalla 2

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen

1. Krijimtaria dhe performanca artistike

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrime etj.

Nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë performuese (interpretuese) në një apo në më shumë veprimtari artistike:

1.	Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrörë etj.).
2.	Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.
3.	Krijon forma të ndryshme dy dhe tridimensionale, duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative.
4.	Luan në instrumente muzikore fëmijërore (të Orfit dhe popullore) sipas prirjes dhe mundësive interpretuese (muzikë).
5.	Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.
6.	Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.
7.	Krijon lëvizje origjinale kreative sipas muzikës, tekstit letrar ose situatës së caktuar (vallëzim, dramë).
8.	Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.

2. Gjuha dhe komunikimi artistik

Nxënësit njojin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

Nxënësi/ja:

1.	Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionet etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
----	---

3. Relacioni art-shoqëri

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasellas, në kontekstin historik, social dhe kulturor.

Nxënësi/ja:

1.	Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).
2.	Emërtón dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.
3.	Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike.
4.	Dallon, krahason dhe prezanton krijues performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.

4. Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

Nxënësi/ja:

- | | |
|----|--|
| 1. | Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të tjerëve), duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës. |
| 2. | Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura, p.sh. "Ky vizatim është i mirë ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se....; Ai/ajo këndoi mirë në ritëm, por melodia nuk ishte e saktë etj.; Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse..." Pra, me gjykim kritik për aq sa lejon mosha dhe aftësia e tyre përfjetuese e veprave. |

II. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen

Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës në natyrë dhe në art

Nxënësi/ja:

- Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Dëshira për shprehje dhe komunikim në mënyrë të pavarur;
- Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme;
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia;
- Përqendrimi dhe durimi.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen

Nxënësi/ja:

- Të vërejturit/të dëgjuarit/aftësitë perceptuese (aftësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë (tin-gullore, të ngjyrave, të formave, të strukturave, të karaktereve, të lëvizjeve etj.);
- Aftësitë përfjetuese artistike;
- Vëmendja dhe memorizimi;
- Vullneti dhe motivacioni;
- Imagjinata dhe krijimtaria;
- Iniciativa dhe interesimi;
- Shkathësitë muzikore;
- Shkathësitë lëvizore;
- Shkathësitë shprehëse figurative;
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar;
- Shkathësia për punë ekipore;
- Të menduarit analistik, kritik dhe krijues.

Planifikimi vjetor i temave mësimore përfushën e kurrikulës: Artet - Klasa IV

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënësit për shkallë)	
	GJYSMËVJETORI I PARË		GJYSMËVJETORI I DYTË			
	shtator—totor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor		
Edukatë muzikore	Këngët Veprat artistike Ngjarjet artistike Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore Lojërat muzikore	Këngët Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore Krijimet muzikore Veprat artistike Ngjarjet artistike Lojërat muzikore Instrumentet muzikore	Këngët Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore Llojet e muzikës Instrumentet muzikore Krijuesit dhe performuesit Krijuesit dhe performuesit	Këngët Llojet e muzikës Instrumentet muzikore Krijuesit dhe performuesit Lojërat muzikore Veprat artistike Ngjarjet artistike	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv I.3, 4, 5,6,8 Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ II 4, 6,7,8. Kompetenca e të nxënësit- Nxënës i suksesshëm III. 1,2,3, 4, 5, 6, 7, 8 Kompetenca personale - Individ i shëndoshë V. 8. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjishëm VI. 2, 6.	
	8	8	11	10		

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Edukatë muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: IV

Temat mësimore: Këngët; Veprat artistike; Ngjarjet artistike; Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrim-leximi; Format muzikore; Lojërat muzikore.

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: Kompetanca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përfjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njëren nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
I.6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, këngë apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.

Kompetanca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njëren nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjeshtir që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minuta.
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vative, shndërrimeve apo pozitave në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimi) të tyre.

Kompetanca e të nxenit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën e problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njës nga format e shprehjes.
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një temë të caktuar.
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
III.4	Ndrekundjezim e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kerkohet prej tij a saj.
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
III.7	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
------	--

Rezultatet e të nxënët të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katorë etj.).
1.5	Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.
1.6	Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.
2.1	Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionet etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
3.4	Dallon, krahason dhe prezanton krijues, performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.
4.1	Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të të tjera), duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës.

Rezultatet e të nxënësit për temë mësimore RNL		Koha mësimore (ore mësimore)	Metodolo- gjia e mësim- dhënies	e vlerësimit a	Ndërlidhja me lendë të tjera mësimore, me çështjet ndërkuriku- lare
<p>Temat mësimore</p> <p>Këngët</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas initimit dhe notacionit simbollik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyren, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike përfémijë sipas instrukSIONeve të mësidihënës të dhë të mënyrë kreative. Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhë në të tjera vepra muzikore që dégjojnë. - Identifikon dukuritë muzikore, ritmike e melodike, në këngët e këndura dhë në veprat e dégjuara. - Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik (gratësitet) dhe lartësitet tingëlore - 7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. - Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përfjetimit të veprës artistike me disa fjalë të thjeshta gratë bisedës dhe vrojtimit; me lëvizje, me mimikë, me mijetë shprehëse të tjera artistike etj. - Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fémijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktikë të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vëtëve tingullit muzikor etj.). - Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojëratëve përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për katë klasë). <p>Elemen-tet bazike të gjuhës artistike</p> <p>Elementet muzikore Shkrim-Jeximi Format muzikore</p> <p>Veprat artistike; Ngjarjet artistike</p> <p>Lojërat muzikore</p>	<p>Njësité mësimore</p> <p>1. Të këndojmë: "Shtator" Bota e tingujve të mësojmë të këndojmë - solist/ja dhe kori</p> <p>2. Të këndojmë: "Katër stinët e vitit"</p> <p>3. Të këndojmë: "Katër stinët e bazuar</p> <p>4. Të dëgjojmë: Nota Sol/ Edward Grieg, "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt)</p> <p>5. Pentagrami</p> <p>6. Të dëgjojmë: Edward Grieg, "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt)</p> <p>7. Të dëgjojmë: Format muzikore: A B A</p> <p>8. Krijon shprehë personal e emocional ndaj përfjetimit të veprës artistike me disa fjalë të thjeshta gratë bisedës dhe vrojtimit; me lëvizje, me mimikë, me mijetë shprehëse të tjera artistike etj. Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fémijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktikë të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vëtëve tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojëratëve përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për katë klasë).</p>	<p>Nr. i orëve 8</p>	<p>Mësimdhënia dhe të nxënët me fémijet në qender dhe gjithëpërfishtira;</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënët e bazuar</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënët e rritjen e kompetencave;</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar;</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënët e diferençuar.</p>	<p>Vlerësim formativ;</p> <p>Vlerësim i vazhdue-shëm;</p> <p>Vlerësim përmble-dhës</p> <p>(Vendos instrumen-tet).</p>	<p>Gjuhë shqipe; Shoqëria dhe mjedis;</p> <p>Edukatë fizike, sportet dhe shëndetit;</p> <p>Shkaktësi për jetë;</p> <p>Njeriu dhe natyra; Edukatë figurative.</p> <p>Çështje ndërkurikulare:</p> <p>Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.</p>

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Edukatë muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: IV

Temat mësimore: Këngët; Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrim-leximi; Format muzikore; Krijimet muzikore; Veprat artistike; Ngjarjet artistike; Lojërat muzikore; Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
i.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njëren nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
I.5	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
I.6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, këngë apo ndonjë ngjarje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vitetë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rrëth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, historiko-shoqërore) në njëren nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjeshterin që e rrithen e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, veteve, shndërrimeve apo pozitave në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimit) të tyre.

Kompetenca e të nxenit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën e problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njës nga format e shprehjes.
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij a saj.
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigimeve të nevojshme.
III.7	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet e mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre a veprimitarje individuale apo të përbashkët në klasë a shkollë apo jashtë saj.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8

Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) përritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti o aktiviteti në bazë klase apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2

Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos përmes mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët.

Rezultatet e të nxënësit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.).
1.2	Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.
1.5	Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.
3.2	Emërtón dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike..
4.1	Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të tjerëve), duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës.
4.2	Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura, p.sh. <i>Ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se...; Ai/ajo këndoi mirë në ritëm, por melodia nuk ishte e saktë etj.; Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse... Pra, me gjykim kritik për aq sa lejon mosha dhe aftësia e tyre përjetuese e veprave.</i>

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësit për temë mësimore RNL	Njësitet mësimore	Metodolo- gjia e mësim- dhënies		e vleresimit Mетодологија (ore mësimore)	Koha mësimore Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurriku- lare
			Burimet			
Këngët	- Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolic (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj).	9. Melodia dhe ritmi 10. Piktura dhe muzika	Nr. i orëve 8	Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja;	Vlerësim formativ;	Gjuhë shqipe; Shoqëria dhe njedisti; Matematikë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; Shkaktësti për jetë;
Elemen- tet bazike të gjuhës artistike	- Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike përfëmijë sipas instrukSIONeve të mësindhënsit dhe në mënyrë kreative.	11. Masa 2/4 12. Të këndojmë: “Himni i Flamurit”		Mësimdhënia dhe të nxënët e bazuar në rritudjen e kompetencave;	Vlerësim përmble- dhës (Vendos instrumen- tet).	
Elementet muzikore Shkrim-lex- imi Format muzikore	- Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësi të dha lartësitet tingëlllore - 7 tingujt muzikor) performim dhe krijim e shprehje muzikore. - Identifikon dukturitë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dégujuara.	13. Vlerat e notave; nota katershë dhe nota tërëshe	14. Të dégiojmë: Camille Saint-Saëns, “Aviary” (nga “Karnaval i kafshëve”)	Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar;		
Krijimet muzikore	- Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjegje muzikore etj.). - Ritmizzon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëregjëzat etj.	15. Gjej dhe emërito instrumentet	16. Të këndojmë: “Viti i Rr”	Mësimdhënia dhe të nxënët e diferencuar.		Arsinim për zhvillimin e qëndrueshmë; Edukim për qytetari demokratike.
	- Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përfjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisëdës dhe vrojtimit; me lëvizje, me mimikë, me mijete shprehëse të tjera artistike etj.					https://www.youtube.com/watch?v=UmoZNL-LBKA

Veprat artistike Njtarjet artistike	<ul style="list-style-type: none"> - Quron dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor e terma adekuatë. - Krijon shprehë për dëgjim të vazhdueshmë të veprave muzikore dhe për muzikim.
Lojërat muzikore	<ul style="list-style-type: none"> - Përshtuan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative etj.), ndonjë ngjarje muzikore artistike, të përijetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV-ja etj. - Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatashme me fjalorin e moshës së tyre, të percjella me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë temë të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vitetë e tingullit muzikor etj.). - Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, minika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).
Instrumentet muzikore	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj. - Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricilkuese dhe organike (marakas me oriz, misët, dajre te vogla etj.).

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Edukatë muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: IV

Temat mësimore: Këngët, Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrim-leximi; Format muzikore, Llojet e muzikës, Instrumentet muzikore, Krijuesit dhe performuesit

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjeterit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njëren nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
I.5	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjeter, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informacioneve të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minuta.
------	--

Kompetenca e të nxënët – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën a problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërs nga format e shprehjes, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një temë të caktuar.
III.3	Identifikon dhe krahason informata e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij a saj.
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) përrarrjen e një qëllimi të përbashkët (projekti o aktiviteti në bazë klase a shkolle apo jashtë saj).
-----	---

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët.
IV.6	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërs rregull të propozuar në formë të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojet e mosbatimit të saj.

Rezultatet e të nxënësit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.3	Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.
1.4	Luan në instrumente muzikore fëmijërore (të Orfit dhe popullore) sipas prirjes dhe mundësive interpretuese (muzikë).
1.5	Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.
1.6	Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.
1.7	Krijon lëvizje origjinale kreative sipas muzikës, tekstit letrar ose situatës së caktuar (vallëzim, dramë).
2.1	Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionet etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
3.4	Dallon, krahason dhe prezanton krijues, performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxenit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (ore mësimore)	Metodolo- gjia e mësim- dhënies	e vleresimit metodologjia	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkuriku- lare	Burimet
Këngët	- Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimt dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë temën të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyren, shkollën, familjen, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instrukSIONeve të mësidi dhënesit dhe në mënyrë kreative.	17. Didaktike: "Dordoleci" - nota Do 18. Kitara 19. Notat La dhe Si 20. Lahuta - të dëgjojmë: Drinor Zymberi, "Epos" - 21. Notat Fa dhe Re 22. Të këndojnë; "Vendi im" 23. Të këndojnë; "Fëmijët e Kosovës" 24. Të këndojnë; "Mami, mami"	Nr. i orëve 11	Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja; Mësimdhënia dhe të nxënët e bazuar në ritjin e kompetencave; Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar;	Vlerësim formativ; Vlerësim i vazhdueshëm; Vlerësim përmblehdës (Vendos instrumentet).	Gjuhë shqipe; Shoqëria dhe mjedisi; Edukatë figurative; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; Matematikë; Shkaktësi për jetë.	Edukatë muzikore 4 "Dukagjini"
Elementet bazike të gjuhës artistike	- Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodië dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera veprat muzikore që dëgjojnë.					Çështjet ndërkurikulare:	
Format muzikore	- Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitetë dhe lartësitetë tingëlore - 7 tingujt muzikor) performim dhe krijim e shprehje muzikore.					Edukum qytetar; Arsimit për zhvillimin e qëndrueshëm; Edukimi për paqe.	https://www.youtube.com/watch?v=dFSPE-EMM88
Llojet e muzikës	- Identifikon dukuri të muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.						https://www.youtube.com/watch?v=IkzjNdhq6NTI

Instrumentet muzikore	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon tē instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike), përmes dëgjimit të veraprave muzikore të përshtatshme për moshën tyre. - Identifikon instrumentet muzikore vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj. - Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluuese dhe organike (marakas me oriz, misër, dajre te vogla etj.). - Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumente të drunjta, të tunxhit, frymore me harqe etj.), mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj. - Njeh disa (10) krijues dhe performues nga veprat e diçgjura muzikore. 	<p>25. Muzika jonë popullore: "Pranvera filloj me ardhë"</p> <p>26. Të dëgjojmë: "Prilli piktor"</p> <p>27. Profesionet</p>
Krijuesit dhe performuesit		

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Edukatë muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: IV

Temat mësimore: Këngët; Krijuesit dhe performuesit, Llojet e muzikës, Lojërat muzikore, Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxenit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjedit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njëren nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërs nga format shprehëse.
II.2	Identifikon çështjet e njëjtë, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imaginatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njëren nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjeshterin që e rrithen e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minuta.

Kompetenca e të nxenit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën a problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërs nga format e shprehjes.
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij a saj.
III.7	Identifikon cilësitë e veta që i posidon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8

Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) përritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti o aktiviteti në bazë klase apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2

Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos përmenyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët.

Rezultatet e të nxënësit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.).
1.2	Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.
1.3	Krijon forma të ndryshme dy dhe tridimensionale, duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative.
1.5	Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.
1.6	Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.
2.1	Identifikon dhe përdor në mënyrë originale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionet etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
3.3	Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësit për temë mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (ore mësimore)	Metodolo- gjia e mësim- dhënies	Metodolo- gjia e vlerësimit	Burimet ndërkuriku- lare	
Këngët	<ul style="list-style-type: none"> - Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupë) sipas imitimit dhe notacionit simbollik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë temë të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natiyren, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). <p>Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me regla muzikore ritmike përfëmijë sipas instrukcioneve të mësimeve të mësimeve kreative.</p> <p>Njeh disa (10) krijues dhei performues nga veprat e dégjuara muzikore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri, përmes dégjimit muzikor (p.sh. muzikë për vallëzim, muzikë për film, teatër, muzikë përfëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.). <p>Krijuesit dhe performuesit</p> <p>Llojet e muzikës</p>	<p>28. Të këndojmë: “Bicikleta”</p> <p>29. Të dëgjojmë: “Simfonia e 5-të e L.V. Beethoven-it”</p> <p>30. “Muzeu, teatri, sala koncentrale dhe galeria”</p> <p>31. Llojet e muzikës</p> <p>32. Të këndojmë: “Kënga e Planetëve”</p> <p>33. “Të dëgjojmë: Fahri Beqiri dhe Vinçenc Gjini, Gjora Feldman “Let's be happy”</p> <p>34. “Kanoni”</p> <p>35. “Lojë ritmike”</p> <p>36. Të ndërtojmë instrumente</p> <p>37. Të këndojmë: “Lamtumi”</p>	<p>Nr. i orëve 10</p>	<p>Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja;</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënët e bazuar në ritjien e kompetencave;</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar;</p> <p>Mësimdhënia dhe të nxënët e diferencaur.</p>	<p>Vlerësim formativ;</p> <p>Vlerësim i vazdueshëm;</p> <p>Vlerësim përmbledhës (Vendos instrumentet).</p>	<p>Gjuhë shqipe; Shoqëria dhe mjedis;</p> <p>Edukatë figurative;</p> <p>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti;</p> <p>Shkaktësi për jetë;;</p> <p>Çështjet ndërkurikulare:</p> <p>Arsimim për zhvillimin e qëndrueshmë.</p>	<p>Edukatë muzikore 4 “Dukagjini”</p> <p>Edukatë muzikore 4 - flutore pune “Dukagjini”</p> <p>CD 4</p> <p>https://www.youtube.com/watch?v=90x8BN3-Meo</p> <p>https://www.youtube.com/watch?v=NLI17scvluM</p>

Lojërat muzikore	- Përzgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme, shfaqjet në klasë, shkollë, komunitet etj. Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, minnika, levizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).
Instrumentet muzikore	- Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj.
Veprat artistike Ngjarjet artistike	- Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike (marakas me oriz, misë, dajre te vogla etj.). - Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përfjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit; me lëvizje, me mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Qëmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike veta nake dhe të të tjerëve me fjalor e termia adekuate. - Krijon shprehë për dëgjim të vazhdueshëm të vepgrave muzikore dhe përmuzikim.



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxenit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grup) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik)...;
Shoqëron këndimin me zë...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.6, III.4, VI.2

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Shtatori"

Rezultatet e të nxenit të orës mësimore:

- Këndon këngën sipas rregullave të këndimit;
- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Plotëson skemën duke u bazuar në pyetjet e parashtruara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, skema në fletë A4, CD nr.1.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Harta e mendimeve

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrëthit shkruan "Shtatori". Detyrë e nxënësve është që të tregojnë se çfarë bëjnë fëmijët më 1 shator. Mendimet e tyre shkruhen në skemën e mëposhtme. Secilit nxënës në mënyrë individuale i shpërndahet e njëjtë skemë, të cilën kanë për detyrë që ta plotësojnë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.



Të këndojojmë



CD 01 Këngë: "Shtatori"

Shtatori

Gëzueshëm



Pyetje:
- Duke qenë se pushimet kanë mbaniar, çka paraqet për ju muaji shtator?
- Përshtuanë dhei tregoni se çka sjell muaji shtator.



Detyra:
- Përsëritni këngët e mësuara më parë.





SHTATORI

Risllaz nga fillimi vallén ta fillojm' e me forca t'reja s'bashku tē këndojm'.

Me libra flotre mblidhemi n'oborre ně shkolla cingerojn' zilet shkollore.

Shtatori eshtë shok quhet dhe bashkin se na fton ně lojë se na fton ně m'sim.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Diskutim i përbashkët

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimdhënësi/ja u drejton pyetje nxënësve rrëth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD-ja me strofën e parë. Nxënësit së bashku e këndojnë strofën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyetjet:

Si eshtë shatori? Kë mbledh ai? Kë takojnë fëmi-jët? Kështu vazhdohet edhe me strofën e dytë. Interpretojnë së bashku strofën e parë dhe të dytë.

Pyetjet:

Kush mblidhet në oborrin e shkollës? Kush cingërron në shkollë? Vazhdojnë me dëgjimin e strofës së tretë. Nxënësit këndojnë strofën e tretë. Pastaj këngën e plotë e këndojnë së bashku. Çka ju pëlqeu më së shumti në këtë këngë? Pse?



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxenit Pesëvargëshi

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Skema duhet plotësuar së bashku me nxënësit.

Shtatori

1. Kush? _____
2. Si eshtë? _____
3. Çfarë bën? _____
4. Një fjali. _____
5. Një emër ndryshe. _____

Detyrë e nxënësve eshtë që ta plotësojnë atë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Në pentagram tē paraqesin këngën me notat muzikore.



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrim leximi; Format muzikore

Resultatet e të nxënët të temës:

Dallon elementet themelore muzikore...;

Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike...

Kontributi në resultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, III.2, III.4, III.7.

Kontributi në resultatet e fushës së kurrikulës: 1.6, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bota e tingujve

Resultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Njeh tingujt rreth vetes;
- Identifikon burimet e tingujve;
- Imiton tinguj të ndryshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi, projektor, laptop, lapsa, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit disa fotografi. Fotografitë lidhen me qytetin dhe pyllin. Nxënësit tē ndarë në dyshe kanë për detyrë t'i emërtojnë dhe tē tregojnë tingujt që ata/ato prodhojnë. Diskutohet rreth përgjigjeve të nxënësve.



Bota e tingujve

Të luajmë së bashku: identifikoni dhe prodhoni tingujt tuaj.



Detyra:

- Proponi të imiton me zë tinguj që ju dëgjoni në qytet.



- Emërtoni kafshët që ju i shihni në ilustrim dhe provoni të imiton me zë tinguj që atë prodhojnë.



Siq e vëreni, ne jemi të rrëthuar me tinguj të ndryshëm, disa më të zëshëm e disa më të qetë.

● Identifikoni tingujt në ilustrime. Me ndihmën e instrumenteve tuaja ose edhe gjësendeve të ndryshme, si: lapsa, fletë, ujë etj., ju mund të prodhoni tinguj. Përdorenë imaginatën dhe eksploroni tingujt!

8



9



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përputimi i përbajtjes *Dëgjo-analizo-thuaja grupit*

Ndahen nxënësitet në katër grupe. Dy grupeve mësuesi/ja ua shpërndan ilustrimin me pamjen e qytetit. Detyrë e tyre është që të analizojnë dhe të imitojnë me zë tingujt që ata i dëgjojnë në qytet. Dy grupeve të tjera mësuesi/ja ua shpërndan ilustrimin me pamjen e pyllit. Detyrë e tyre është që të analizojnë dhe të imitojnë me zë tingujt që ata i dëgjojnë në pyll.

Prezantohet dhe diskutohet puna e secilit grup. Në fund grupet kanë për detyrë të tregojnë se cilët janë tingujt më të zëshëm dhe cilët më të qetë.

Nxënësit tregojnë se çfarë u ka pëlqyer më së shumti në punën grupore dhe pse.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës
Bashkëpunojmë dhe imitojmë**

Nxënësit ndahen në katër grupe, ku secili grup ka për detyrë që me ndihmën e instrumenteve të tyre ose gjësendeve të ndryshme (laps, fletë

et.) t  prodhojn  tinguj t  ndrysh m. Nx n s it duke p r dorur imagjinat n e tyre eksplorojn  tinguj t  ndrysh m.

Prezantohet dhe diskutohet puna e grupeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, njohjen dhe mënyrën e interpretimit të tingujve.

Detyrë:

Fletore pune (fq.4).



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrim leximi; Format muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodja dhe harmonia (dur-mol)) në këngët...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.5.6. II.8 III.2.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të mësojmë të këndojojmë - solisti/ja dhe kori

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Përgigjet në pyetjet e parashtruara;
- Interpreton solistin/korin;
- Liston dallimet dhe të përbashkëtat e solistik dhe korit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, projektor, laptopi, etiketa, CD nr. 02, 03, 04.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim

Nxënësve u drejtohen pyetjet:


Kërkohet nga nxënësit që nga programet e ndjekura shkollore apo televizive, të kujtojnë një vepër, paraqitje që është kënduar në kor dhe një që është kënduar nga një solist. Pyeten se në cilin rast kanë përfjetuar ndjenja më të forta dhe pse.

Të mësojmë të këndojojmë

Solisti/ja dhe kori

Për zërin thonë se është instrumenti më i përsosur. Nëse këngëtarë këndon vetë, atë do ta quajmë **solist**, por nëse një grup më i madh këngëtarësh këndojnë bashkërisht, atëherë këtë grup do ta quajmë **kor**.

● Si t'i shqiptojmë drejt zanoret?



Që të këndosh buruk, qoftë si solist, qoftë në kor, duhet të kesh kujdes që:

- të qëndrosh drejt,
- ta hapësh gojën,
- t'i shqiptosh drejt fjalët dhe të kesh kujdes në këndimin e drejtë të zanoreve a, o, i, e, u, y, è.


10

Të mësojmë të këndojojmë

Solisti/ja dhe kori

Për zérin thonë se është instrumenti më i përsosur. Nëse këngëtari këndon vetë, atë do ta quajmë **solist**, por nëse një grup më i madh këngëtarësh këndojnë bashkërisht, atëherë këtë grup do ta quajmë **kor**.

● Si t'i shqiptojmë drejt zanoret?



Që të këndosh bukur, qoftë si solist, qoftë në kor, duhet të kesh kujdes që:

- të qëndrosh drejt,
- ta hapësh gojën,
- t'i shqiptosh drejt fjalët dhe të kesh kujdes në këndimin e drejtë të zanoreve a, o, i, e, u, y, ë.

10

Diskutohet rreth përgjigjeve të nxënësve.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përbajtjes
Mendo-puno-thuaja grupit

Ndahen nxënësit në katër grupe. Në secilin grup shpërndahen pyetjet e përpiluara nga mësuesi/ja.

Kush është instrumenti më i përsosur?

Si quhet këngëtari që këndon vetë?

Si quhet një grup më i madh këngëtarësh që këndojnë bashkërisht?


Për të kënduar bukur, cilat rregulla duhen ndjekur?
Zgjedh një këngë ku do të këndoje solisti-ja/kori (së bashku).

Prezantohet dhe diskutohet puna e secilit grup.
Hapet libri në faqen 10. Analizohen ilustrimet e paraqitura në libër. Nxënësit mësojnë se si t'i shqiptojnë drejt zanoret.

Nxënësit tregojnë se çfarë u ka pëlqyer më së shumti në punën grupore dhe pse.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës
Diagrami i Venit



Mësuesi/ja secilit nxënës në mënyrë individuale ia shpërndan skemën e mëposhtme.

Së pari dëgjojnë këngët nga CD nr.02, 03, 04 pastaj detyrë e nxënësve është që të tregojnë dallimet dhe njashmëritë mes solistikës dhe korit.

Prezantohet dhe diskutohet puna e nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, krahasimin e tyre dhe interpretimin e drejtë të solistikës dhe korit.

Detyrë:

Hulumtim: Të gjejnë dhe të shkruajnë për ndonjë solist apo soliste më të njohur shqiptare.

Reflektime përmirësime:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënët të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grup) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik)...; Shoqëron këndimin me zë...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.6, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndoymë: "Katër stinët e vitit"

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Interpreton këngën individualisht/grup;
- Shoqëron këngën me ndonjërin nga instrumentet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptopi, CD nr.05, instrumente muzikore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Pyetje-përgjigje

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Cila është stina juaj e preferuar? Pse?

Kërkohet nga ata që të shkruajnë me fjale stinën që preferojnë.

Përmendin ndonjë kompozitor që ka kompozuar dhe është frysmeuar nga stinët e vitit.

Diskutohet rrith përgjigjeve të nxënësve.



Të këndoymë



CD 05 Këngë: "Katër stinët e vitit"

Katër stinët e vitit

Muzika: Edmond Zhulali

Teksti: Agim Doçi

Shejt

Pot'më pësimu - a vjesh-tën shum' e du - a Pe-mët mbu-shen plot me moll'

gjith' fë - mi - jët shkojn' né shkoll' - Di - mri n shum' e du - a

Ti vje-shtën e zgjo - dhe di - mri ka gësh - te - nya por s'ka a - ku - llo - re

Nuk ka a - ku - llo - re por ka to - pa bo - re

Un' dhe sho - ku im e du - am çdo stin' se çdo vit ka ka - têr

as - një s'shkon me ha - têr Pran - ver - ra ve - ra,

vje - shta, di - mri, ka - têr sti - nêt që ka vi - ti shum' i du - am ne



Dallo tingujt e lartë dhe

tingujt e ulët.

Ndahuni në katër grupe, ku

secilat grup i caktohet njëra

stinë.

Paraqitni ndryshimin e

stinëve të vitit përmes vizati-

mit, duke u bazuar në tekstin

e këngës.


12

Pyetje:

- Cila është stina juaj e preferuar dhe pse?
- Përkruani me fjale stinën që ju e preferoni.
- Përmendni ndonjë kompozitor që ka kompozuar dhe është frysmeuar nga stinët e vitit.



Të këndojmë



CD 05 Këngë: "Katër stinët e vitit"

Katër stinët e vitit

Muzika: Edmond Zhulali
Teksti: Agim Doçi

Shpejt

Po'më pye-snimu a vjesh-tën shum' e du - a Pe-mët mbu-shen plot me moll'
gjith' fe - mi - jët shkojn' në shkoll' Di - mriñ shum' e du - a

Ti vje-shtën e zgjo - dhe di - mri ka gësh - te-nja por s'ka a - ku-lo-re

Nuk ka a - ku-lo-re por ka to - pa bo - re

Ref:

Un' dhe sho - ku im e du-am çdo stin' se çdo vit ka ka - tér

as - një s'shkon me ha - té Pran - ver - ra ve - ra,

vje - sta, di - mri, ka - tér sti - nët që ka vi - ti shum' i du - am ne

D.C.

Detyra:

- Dallo tingujt e lartë dhe tingujt e ulët.
- Ndahuni në katër grupe, ku secilit grup i caktohet njëra stinë.
- Paraqitni ndryshimin e stinëve të vitit përmes vizatimit, duke u bazuar në tekstin e këngës.

12

Pyetje:

- Cila është stina juaj e preferuar dhe pse?
- Përshkruani me fjalë stinën që ju e preferoni.
- Përmendni ndonjë kompozitor që ka kompozuar dhe është fyrmezuar nga stinët e vitit.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përpunimi i përbajtjes
Dëgjo-mëso-përgjigju**

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalesë, mësimdhënësi/ja nxënësve u drejton pyetje rreth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD-ja me pjesën e parë.

Nxënësit së bashku këndojnë pjesën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyetjet:

Në cilën stinë fillojnë fëmijët të shkojnë përsëri në shkollë? Kush mbushen me mollë?

Kështu vazhdohet edhe me pjesën e dytë. Interpretojnë së bashku pjesën e parë dhe të dytë.

Pyetjet:

Cfarë ka në stinën e dimrit? Sa stinë ka çdo vit?

Vazhdojnë me dëgjimin e pjesës së tretë.

Nxënësit e këndojnë strofën e tretë.

Pastaj këngën e plotë e këndojnë së bashku.

Çka ju pëlqeu më së shumti në këtë këngë? Pse?



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit

Veprimitari në grupe

Në këtë pjesë të orës mësimore nxënësit kanë për detyrë të dallojnë tingujt e lartë dhe tingujt e ulët. Nxënësit ndahen në katër grupe, ku secilit grup i caktohet të këndojnë nga një strofë të këngës, kurse grupi tjeter përcjell me ndonjërin instrument apo me duar.

Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit dhe përcjelljen me instrument të këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrim leximi; Format muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodja dhe harmonia...); Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për performim dhe krijim e shprehje muzikore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 5; II.7; III.2,3,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pentagrami

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Klasifikon notat muzikore;
- Radhit notat muzikore në pentagram;
- Argumenton radhitjen e notave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: pentagrami, etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Arsirim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Copëzat e përziera

Nxënësve u shpërndahen etiketa me vijat e paraqitura dhe notat muzikore. Ata e formojnë pentagramin dhe i vendosin notat në vendet e tyre. Disa nxënës e paraqesin punën e tyre para shokëve/shoqeve.

Pentagrami

Të rikujtojmë:
 - Pentagrami ka _____ vija
 - Pentagrami ka _____ hapësira.

- Vendi ku vendosen notat quhet _____.
Sipas vendit që zënë në këtë shtëpi, marrin emrin e tyre.
- Pentagrami ka pesë vija

1	2	3	4	5	Vija e pestë Vija e katërt Vija e tretë Vija e dytë Vija e parë
---	---	---	---	---	---

dhe 4 hapësira

1	2	3	4	Hapësira e katërt Hapësira e tretë Hapësira e dytë Hapësira e parë
---	---	---	---	---

● Por, notat ndonjëherë i shënojmë edhe nën ose mbi të. Në këto raste, përdorim vija ndihmëse.

Ja si duken notat në pentagram:

Pyetje:
 - Ku duhet vendosur nota Sol në pentagram?
 - Pse quhet çelësi i Solit?




Pentagrami

Të rikujtojmë:
 - Pentagrami ka _____ vija
 - Pentagrami ka _____ hapësira.

- Vendi ku vendosen notat quhet _____.
 Sipas vendit që zënë në këtë shtëpi, marrin emrin e tyre.

- Pentagrami ka pesë vija



dhe 4 hapësira



- Por, notat ndonjëherë i shënojmë edhe nën ose mbi të. Në këtë raste, përdorim vija ndihmëse.

Ja si duken notat në pentagram:



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e klasifikimin, radhitjen dhe argumentimin e vendosjes së notave.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune në faqen 4.

Reflektime për rrjetëshkën e orës mësimore:



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Mendo-analizo-klasifiko

Ndahen nxënësit në katër grupe. Hapen librat në faqen 13. Analizohen shembujt që janë dhënë. Nxënësit mësojnë se si duken notat në pentagram.

Krahasojnë notat që i kanë radhitur vetë me ato të cilat janë të paraqitura në tekstin.

Detyrë e nxënësve është që t'i klasifikojnë notat dhe t'i vendosin në vendin e duhur. Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet. Grupi më i shpejtë dhe më i saktë shpallet fitues.

Nxënësit tregojnë se çfarë u ka pëlqyer më së shumti në punën grupore dhe pse.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve Pyetje-përgjigje

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Ku duhet vendosur nota Sol në pentagram?

Pse quhet çelësi i Solit?

A janë radhitur mirë notat? Po, pse? Jo, pse?

Argumentohen përgjigjet e nxënësve.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike;

Elementet muzikore; Shkrim leximi; Format muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodja dhe harmonia...); Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për performim dhe krijim e shprehje muzikore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 5. II.7, III.2,3,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nota Sol

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Nënviron notën sol në pentagramin e paraqitur në tekst;
- Paraqet këngën me notat muzikore në pentagram;
- Përbledh përkufizimin e notës sol.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materiale mësimore:

pentagram, projektor, laptop, fletë A4, CD nr. 06

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i përbashkët

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Ku duhet vendosur nota Sol në pentagram?

A e dini se pse quhet çelësi i Solit?

Diskutohet rreth përgjigjeve të tyre.

Nota Sol

CD 06 Didaktike: "Solisti"

Sol, sol, sol, sol - ist ësh't bë'r Ri - no - ri me zë 'tbu-kur prej e - no - n
shum' shpejt kët' djal' ko - so - var do ta njoh' të'r bo - ta mbaj'

SHKOLLA
Burim Hoxha

Në mëngjes herët u zgjova, fytyrë e dhëmbë i pastrova, në çantë librat i palova, solo-këngë në shkollë këndova.

Pyetje:

- Ku duhet vendosur nota Sol në pentagram?
- A e dini se pse quhet çelësi i Solit?

Detyra:

- Rretho notën Sol në pentagram.

Fjalorëthi:
tenor - është zëri i lartë i meshkujve.

15

Nota Sol

CD 06 Didaktike: "Solisti"

Sol, sol, sol, sol - ist ēsh't bēr' Ri - no - ri me zē t'bu-kur prej le - mo -
shum'shejt kēt' djal' ko - so - var do ta njoh' tēr' bo - ta mba'

SHKOLLA
Burim Hoxha

Në mëngjes herët u zgjova, ftyrë e thimbë i pastrova, në çantë librat i palova, solo-këngë në shkollë këndova.

Pyetje:
- Ku duhet vendosur nota Sol në pentagram?
- A e dini se pse quhet çelësi i Sol-it?

Detyra:
- Rretho notën Sol në pentagram.

Fjalorthi:
tenor - ēsh't zëri i lartë i meshkujve.

15



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Mendo-puno-thuaja grupit

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimdhënësi/ja u drejton nxënësve pyetje rreth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD-ja. Kënga e plotë këndohet së bashku.

Kërkohet nga nxënësit që t'i hapin librat në faqen 15. Deyrë e tyre është që ta rrethojnë notën Sol në pentagramin e dhënë në libër.

Në fletoren e pentagramit e paraqesin këngën me notat muzikore. Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet.

Pyeten nxënësit se çfarë u ka pëlqyer më së shumti gjatë kësaj ore mësimore dhe pse.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxenit Dëgjo-identifiko-ngjyros

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Po ashtu u shpërndahen nxënësve skema në fletën A4.

1. Kush? _____
2. Si duket? _____
3. Çfarë bën? _____
4. Një fjali. _____
5. Një emër ndryshe. _____

Nota Sol

Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë atë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përcaktimit të notës *Sol*, paraqitjen e këngës në pentagram dhe plotësimin e skemës duke iu përgjigjur pyetjeve.

Detyrë:

Fletore pune në faqe 16, 17.

Reflektim për rrjetëkin e orës mësimore:

Mësimi

7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Veprat artistike; Ngjarjet artistike

Rezultatet e të nxënët të temës:

Shpreh reagimin personal emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta...;
Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të dëgjojmë: Edvard Grieg, "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt)

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Identifikon rrugëtimin e instrumenteve;
- Përgjigjet në pyetjet e parashtruarë;
- Ngjyrosin instrumentet e identikuara gjatë dëgjimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, instrumentet në fletë A4, pyetjet e përgatitura, CD nr.07

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Rikujtojmë duke dëgjuar

Mësuesi/ja fillmisht shfaq para nxënësve veprën Edvard Grieg, "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt). (<https://www.youtube.com/watch?v=dyM2AnA96yE>). Nga nxënësit kërkohet që ta dëgjojnë veprën me kujdes.




Të dëgjojmë:

Edvard Grieg, "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt)



CD ët bëqim Edvard Grieg - "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt)



Dëgjo veprën me kujdes dhe në të njëjtën kohë përcill grafikën, duke pasur kujdes në ritëm.



- A mund t'i identifikosh lehtë instrumentet që përdoren në vepër?


16



Të dëgjojmë:

Edvard Grieg, "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt)

CD 03 Dëgjim Edvard Grieg - "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt)



Dëgjo veprën me kujdes dhe në të njëjtën kohë përcill grafikën, duke pasur kujdes në ritëm.



- A mund t'i identifikosh lehtë instrumentet që përdoren në vepër?

16



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Mendo-puno-thuaja grupit

Kërkohet nga nxënësit që t'i hapin librat në faqen 16. Detyrë e tyre është që ta përcjellin grafikën e dhënë në libër duke pasur kujdes në ritëm dhe të identifikojnë rrugëtimin e secilit instrument.

Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet.

Pas prezantimit të punës grupore, në secilin grup shpërndahen pyetjet e formuluara nga mësuesi/ja.

- A mund t'i identifikoni lehtë instrumentet që përdoren në vepër? Po, si? Jo, pse?

- Përshkruani me pak fjalë emocionin që kjo vepër ju ka dhënë.

- Çdo instrument ka ngjyrën e vet, ju cilën nga to e pëlqeni?

- Po ju, a luani ndonjë nga këto instrumente? Nëse po, cili është ai?

Detyrë e nxënësve është që të gjejnë përgjigjet e tyre. Mendimet diskutohen.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit Dëgjo-identifiko-ngjyros

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit do të dëgjojnë nga CD-ja Edvard Grieg - "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt). Në të njëjtën kohë do të ngjyrosin edhe instrumentet që i kanë identifikuar e që janë përdorur në vepër (flauti, oboë, harqet).

Puna e nxënësve monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe identifikimin e instrumenteve muzikore.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin veprën e paraqitur në faqen 16.

Reflektime për rrjetërin e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Lojërat muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Luan lojëra të thjeshta muzikore, tē shoqëruara me këngë...;

Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.5,6. II.8. III.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Format muzikore: A B A

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Identifikon pjesët ABA gjatë dëgjimit të këngës;
- Argumenton punën në grup;
- Përbledh njohuritë për Beethovenin duke iu përgjigjur pyetjeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, fletë A4 me skemën e përgatitur, CD nr.08, 09.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Rikujtojmë duke luajtur

Mësuesi/ja fillimisht lëshon para nxënësve një melodi. Gjatë kohës që nxënësit e dëgjojnë melodinë e pjesës së parë A, ata do të sillen bashkë në rreth. Kur ta dëgjojnë melodinë e pjesës së dytë B, ulen të gjithë. Me të dëgjuar pjesën e parë, përsëri do të sillen në rreth e kështu me radhë. Kjo lojë përsëritet derisa të zgjatë kompozimi.

Format muzikore

A B A

CD 08 Forma AB
CD 09 Kënga tripljesore A B A

Kënga dypjesore




- Dëgjo këngën CD 08 "Erdh pranvera" dhe gjej pjesën e parë A dhe pjesën e dytë B.
- Dëgjo veprën e Beethoven-it dhe gjej pjesën A, pjesën B dhe përsëritjen e pjesën A.

Kënga tripljesore



• Të luajmë së bashku:

Gjatë kohës që e dëgjoni melodinë e pjesës së parë A, ti me shokët dhe shoqet e tua do të silleni bashkë në rreth. Kur ta dëgjoni melodinë e pjesës së dytë B, uluni të gjithë. Me të dëgjuar pjesën e parë, përsëri do të sillen në rreth e kështu me radhë. Kjo lojë përsëritet, derisa zjat kompozimi.



18

Format muzikore

A B A

Kënga dypjesore



CD 08 Forma AB
CD 09 Kënga tripjesore A B A



- Dëgjo këngën CD 08 "Erdh pranvera" dhe gjej pjesën e parë A dhe pjesën e dytë B.
- Dëgjo veprën e Beethoven-it dhe gjej pjesën A, pjesën B dhe përsëritjen e pjesën A.

Kënga tripjesore



• Të luajmë së bashku:

Gjatë kohës që e dëgjoni melodinë e pjesës së parë A, ti me shokët dhe shoqet e tua do të silleni bashkë në rrith. Kur ta dëgjoni melodinë e pjesës së dytë B, uluni të gjithë.

Me të dëgjuar pjesën e parë, përsëri do të silleni në rrith e kështu me radhë. Kjo lojë përsëritet, derisa zgjat kompozimi.

18

1. Kush?

Beethoven

2. Si është?

3. Çfarë bën?

4. Një fjali.

5. Një emër ndryshe.

Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë atë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e njohurive për Beethovenin dhe për identifikimin e pjesës ABA.

Detyrë:

Të mësojnë një këngë tripjesore ABA sipas dëshirës.



Reflektim për rrejdhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Krijimet muzikore

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.); Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëegjëzat etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.5.6. II.8. III.2,3 V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Melodia dhe ritmi

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Dallon notat e shkurtra dhe të gjata;
- Krijon melodinë dhe ritmin;
- Identifikon dallimet dhe të përbashkëtat e melodisë dhe ritmit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4 me skemën e Diagramit të Venit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuha shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i përbashkët

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Si krijohet melodia?

Si ndërtohet ritmi?

Cilat janë nota të gjata?

Cilat janë nota të shkurtra?

Diskutohet rreth përgjigjeve të tyre.

Melodia dhe ritmi

- Duke radhitur notat në pentagram, krijojmë **melodi**. Përderisa, vlerat e notave do të na shërbejnë që të ndërtojmë **ritmin**.
- Në këtë shembull do të shihni se notat mund të jenë të gjata dhe të shkurtra.

DO DO DO RE MI RE DO MI RE RE DO

Detyra:
 - Dallo notat e shkurtra dhe të gjata!
 - Krijoni melodinë dhe ritmin tuaj.

19

Melodia dhe ritmi

- Duke radhitur notat në pentagram, krijojmë **melodi**. Përderisa, vlerat e notave do të na shërbejnë që të ndërtojmë **ritmin**.
- Në këtë shembull do të shihni se notat mund të jenë të gjata dhe të shkurtra.

Detyra:

- Dallo notat e shkurtra dhe të gjata!
- Krijoni melodinë dhe ritmin tuaj.

19

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e gjetjes së tingullit të gjatë dhe të shkurtër, krijimin e melodisë dhe të përbashkëtat e dallimet në mes melodisë dhe ritmit.

Detyrë:

Të krijojnë ndonjë melodi apo ritëm sipas shembullit të dhënë në faqen 19.

Reflektim për rrjetën e orës mësimore:



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përpunimi i përmbytjes
Mendo-puno-thuaja grupit**

Kërkohet nga nxënësit që t'i hapin librat në faqen 19.

Nxënësit, të ndarë në grupe, kanë për detyrë që në shembullin e dhënë në libër të dallojnë notat e shkurtra dhe të gjata.

Detyrë e secilit grup po ashtu është që të krijojnë melodinë dhe ritmin e tyre.


Nxënësit ritmizojnë melodinë e krijuar.

Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve
Diagrami i Venit**

Mësuesi/ja secilit nxënës në mënyrë individuale ia shpërndan skemën e mëposhtme. Detyrë e tyre është që të tregojnë dallimet dhe ngjashmëritë mes ritmit dhe melodisë. Prezantohet dhe diskutohet puna e nxënësve.



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Veprat artistike; Ngjarjet artistike

Rezultatet e të nxënët të temës:

Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta...; Çmon dhe vlerëson performancën...; Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim; Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse, si: me gojë)...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.4, III.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Piktura dhe muzika

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Bashkon pikturat me autorët e tyre;
- Krijon shprehi për të dëgjuar;
- Shfaq emcionet gjatë komentimit të pikturave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Piktura dhe muzika

Artistët figurativë shpeshherë fryshtimin e kanë gjetur te kompozitorët, por edhe anasjellas. Ta zëmë, Kandinsky është fryshtuar nga stili i vezantë i kompozitorit austriak Arnold Schoenberg, përdërisa kompozitori rus, Modest Mussorgsky, është inspiruar nga Viktor Hartmann-i. Andaj edhe vepra e Mussorgsky-t mban titullin "Pikturat në një ekspozitë".




Pablo Picasso



Wassily Kandinsky



Leonardo da Vinci



Van Gogh

Bashkë do të dëgjojmë një vepër dhe, gjatë dëgjimit, do të pikturojmë dhe do të shfaqim emcionin përmes lapsit dhe ngjyrave.

21

Piktura dhe muzika

Artistët figurativë shpeshherë fryshtojnë e kanë gjetur te kompozitorët, por edhe anasjellas. Ta zëmë, Kandinsky është fryshtuar nga stilii i veçantë i kompozitorit austriak Arnold Schoenberg, përdorësia kompozitorit rus, Modest Mussorgsky, është inspiruar nga Viktor Hartmann-i. Andaj edhe vepra e Mussorgsky-t mban titullin "Pikturat në një ekspositë".



Bashkë do të dëgjojmë një vepër dhe, qjatë dëgjimit, do të pikturojmë dhe do të shfaqim emocionin përmes lapsit dhe ngjyrave.

21



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Mendo-analizo-emërto

Nxënësit ndahen në grupe. Mësuesi/ja në secilin grup shpërdan 4 pikturat e dhëna në libër dhe 4 emrat e piktorëve që i kanë punuar ato. Nxënësit e kanë për detyrë që të vendosin emrin e piktorit pranë pikturës që e ka punuar ai. Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet. Prezantohet dhe diskutohet puna e secilit grup. Grupi më i shpejtë shpallet fitues. Pyeten se çka u pëlqeu më së shumti në këto piktura dhe pse.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve Dëgjo-mendo-pikturo

Nxënësit do të dëgjojnë një vepër ku gjatë dëgjimit, detyrë e tyre është të pikturojnë dhe të shfaqin emocionin e tyre përmes lapsit dhe ngjyrave. Eksposohen dhe krahasohen punimet e përfunduara. Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shprehinë e dëgjimit, saktësinë e bashkimit të pikturave me autorët dhe shprehjen e emocioneve përmes pikturimit.

Detyrë:

Të krijojnë ndonjë melodi apo ritëm sipas shembullit të dhënë në faqen 19.

Reflektim për rrjetëshën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Lojërat muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Luan lojëra të thjeshta muzikore e të shoqëruara me këngë të cilat e kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore; Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.5. 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Masa 2/4

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Shkruan në pentagram shembullin në libër;
- Demontron ritmin në sint;
- Krijon rrokje duke zëvendësuar masën 2/4.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: lapsa, shkopinj, sint, pentagram.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Pyetje-përgjigje

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Si fitohet masa?

Me çka e kufizojmë masën?


Kush e përbën masën dypjesore?

Diskutohet rreth përgjigjeve të nxënësve.

Masa $\frac{2}{4}$

Un' me sho - kë do t'më - soj të gjitha no - tat t'i kën - doj.

Do do re re mi mi fa mi mi re re do do do




• Në tekstin gjëeqjëzë që po e themi, shohim se ndonjë rrokje është e theksuar e ndonjëra më pak. Nëse i bëjmë bashkë një rrokje të theksuar e një të pathëksuar, fitojmë një masë.

• Masën do ta shënojmë (kufizojmë) me një vijë vertikale.

• Masa e përbërë prej një rrokjeje të theksuar dhe prej një pjese të pathëksuar quhet **masë dypjesore**. $\frac{2}{1} = \frac{2}{4}$

1 2 1 2
Un' me sho - kë do t'më - soj të gjitha no - tat t'i kën - doj.

II



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes *Mendo-puno-praktiko*

Nxënësit hapin librat në faqen 22. Përshkruajnë në fletoren e pentagramit shembullin e dhënë në libër. E mësojnë ritmin e këngës duke e praktikuar me sint.

Mësojnë se nëse bëhen bashkë një rrokje e theksuar e një e patheksuar, fitojmë një masë. Masa shënohet (kufizohet) me një vijë vertikale. Masa e përbërë prej një rrokjeje të theksuar dhe prej një pjese të patheksuar quhet masë dypjesore. Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet. Pyeten se çka u pëlqeu më së shumti në këtë këngë dhe pse.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit *Lojë me rrokje*

Nxënësit provojnë të gjejnë nga dy rrokje, të cilat e zëvendësojnë masën 2/4.

Për shembull: shko - lla, no - ta, lo - ja. Vazhdojnë të luajnë me rrokje. Mund të shënojnë edhe emrat e tyre. Pasi t'i kenë shënuar shembujt në tabelë, tani mund t'i taktojnë. Këtë lojë me

rrokje mund ta shoqërojnë me ndonjë instrument ritmik, ku rrokja e theksuar të jetë dora poshtë, me shuplaka, ndërsa në pjesën e dytë me lapsa.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e ritmit me sint, paraqitjen e ushtrimit në pentagram dhe krijimin e rrokjeve për të zëvendësuar masën 2/4.

Detyrë:

Fletore pune (faqja 21).

Reflektim për rrjetërin e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënët të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grup) sipas imitimit dhe nacionit simbolik (grafik)...; Shoqëron këndimin me zë...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.6, III.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojmë: "Himni i Flamurit"

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Mëson himnin duke dëgjuar;
- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Plotëson skemën duke u bazuar në pyetjet e parashtruara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i përbashkët

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Kush e shkroi himnin e flamurit kombëtar?

Cili është simboli i tij?

Kush e pëlqeu?

Ku është dallimi në mes flamurit kombëtar dhe shtetëror?

Në cilat raste përdoret?

Diskutohet rreth përgjigjeve të nxënësve.





Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përputimi i përbajtjes *Dëgjo-mëso-thuaja grupit*

Dëgjohet himni me ndalesa në linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=kJORB-PlLCa8> Pas çdo ndalese, mësuesi/ja nxënësve u drejt qytetarët rreth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet në projektor strofa e parë. Nxënësit së bashku këndojnë strofën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyetjet:

Për çfarë bëhet fjalë në strofën e parë? Kujt i dedikohet?

Kështu vazhdohet edhe me strofën e dytë. Interpretojnë së bashku strofën e parë dhe të dytë

Pyetjet:

Si quhen personat që largohen nga lufta? Si quhen personat që e japid jetën për atdhe?

Vazhdojnë me dëgjin e strofës së tretë dhe të katërt.

Nxënësit e këndojnë strofën e tretë pastaj të katërt. Pastaj e këndojnë së bashku.



Përvetësime: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës *Pesëvargëshi*

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Skema duhet plotësuar së bashku me nxënësit.

- | | |
|----------------------|-----------|
| 1. Kush? | Shqiponja |
| 2. Si është? | _____ |
| 3. Çfarë bën? | _____ |
| 4. Një fjali. | _____ |
| 5. Një emër ndryshe. | _____ |

Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë atë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe mënyrën e interpretimit të himnit.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin himnin me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike;

Elementet muzikore;

Shkrim leximi;

Format muzikore.

Rezultatet e të nxënët të temës:

Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për gjatësitë dhe lartësitë tingëlllore; Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.5.6. II.8. III.2,3 V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerat e notave: nota katërshe dhe nota tetëshe

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Përgjigjet në pyetjet e parashtruarë;
- Identifikon notat katërshe dhe tetëshe në tekstin e dhënë;
- Ndërton notat nga kartoni.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, karton, gérshërë

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathëtësi për jetë, Edukatë figurative, Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diagrami i Venit

Mësuesi/ja secilit nxënës në mënyrë individuale i shpërndan skemën e mëposhtme. Detyrë e tyre është që të tregojnë dallimet dhe ngashjmëritë mes notës katërshe dhe notës tetëshe. Prezantohet dhe diskutohet puna e tyre.



Vlerat e notave

Nota katërshe dhe nota tetëshe

- Në tekstin "Vjeshta", por edhe në këngët e mëparshme, keni vërejtur tingujt më të gjatë dhe tingujt më të shkurtër.
- Tingujt më të gjatë mund t'i shënojmë me shenjë të vërtetë muzikore, të cilën do ta quajmë notë katërshe.
- Nota katërshe shënohet duke e vizatuar së pari kokën e saj, pastaj edhe qafën e saj.
- Ia, pra, nota katërshe do të duket kështu:




- Tingujt e shkurtër do t'i quajmë nota tetëshe. Shënohen si notat katërshe, vetëm se u shtohet një flamur.



- Mbani mend! Një notë katërshe vlen sa dy nota tetëshe.



u





Të luajmë së bashku: me nota katërshe dhe me nota tetëshe

• Trokitni duke ligjëruar.

• Ushtrimet ritmike mund t'i luani në ndonjë instrument (dajre, triangël, me shkopinj), por edhe me duartrokotje.

II

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për punimin e notave prej kartonit, për saktësinë e identifikimit të notave katërshe dhe tetëshe.

Detyrë:

T'i ngjyrosin dhe t'i rrethojnë notat katërshe dhe tetëshe në një këngë të përzgjedhur.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përputimi i përbajtjes
Dëgjo-mendo-vapro

Dëgjohet kënga "Vjeshta" që është mësuar më herët. Nxënësit rikujtojnë tingujt më të gjatë dhe tingujt më të shkurtër që kanë vërejtur.

Mësojnë se nota katërshe shënohet duke e vizatuar së pari kokën e saj, pastaj edhe qafën e saj. Nxënësve u duhet shpjeguar se tingujt e shkurtër do t'i quajmë nota tetëshe. Shënohen si notat katërshe, vetëm se u shtohet një flamur.

U theksohet se një notë katërshe vlen sa dy nota tetëshe.

Udhëzohen që me ngjyrë të kuqe të nënvoizojnë notat katërshe, kurse me të kaltër notat tetëshe. Puna e nxënësve monitorohet dhe ndihmohet. Pyeten çka u pëlqen më së shumti në këtë këngë dhe pse.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve
Veprimitari krijuese

Nxënësit në grupe do të punojnë notën katërshe dhe notën tetëshe prej kartonit. Eksposohen dhe krahasohen punimet e përfunduara. Puna e nxënësve monitorohet dhe ndihmohet.

Reflektim për rrjetëshen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Veprat artistike; Ngjarjet artistike

Rezultatet e të nxënët të temës:

Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike...; Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike...; Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave...; Përshkruan dhe komenton ndonjë ngjarje muzikore...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.2, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të dëgjojmë: Camille Saint-Saëns, "Aviary" (nga "Karnavali i kafshëve")

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Krijon shprehi të dëgjimit;
- Shpreh emocionet gjatë komentimit të këngës;
- Njeh Camille Saint-Saëns.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD nr. 12, fletë A4, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjesdisi, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS





Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Harta e mendimeve

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrëthit shkruan "Camille Saint Saëns". Mendimet e nxënësve shkruhen në skemën e mëposhtme. Secilit prej tyre në mënyrë individuale i shpërndahet e njëjtë skemë. Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë. Disa prej tyre lexohen.





Të dëgjojmë: Camille Saint-Saëns, "Aviary" (nga "Karnavali i kafshëve")

CD 12 Camille Saint-Saëns, "Aviary"

Ne veprën e titulluar "Karnavali i kafshëve" autorri Saint-Saëns-i përshkruan kafshët e ndryshme: elefantin, kangurin, peshqit, mijellmén etj.



Mësojmë:

Në veprën e titulluar "Karnavali i kafshëve" kompozitori Saint-Saëns-i përshkruan kafshët e ndryshme: elefantin, kangurin, peshqit, mijellmén etj.

Camille Saint-Saëns-i ishte kompozitor, pianist, dirigjent francez. Ai cili është një qeni. Saint-Saëns-i përfundoi të parë koncerto në moshën 10-vjeçare.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Vëzhgo-analizo-thuaja grupit

Mësuesi/ja shfaq për disa minuta në videoproyektor videon me këngën e Camille Saint-Saëns, "Aviary" (nga "Karnavali i kafshëve") ose CD me numër 12.

(<https://www.youtube.com/watch?v=UmoZNL-LBKA>).

Nxënësit duhet që ta vështrojnë me kujdes videon e paraqitur.

Komenton me gojë ngjarjen muzikore të dëgjuar gjatë orës muzikore.

Paraqet emocionet e veta përmes vizatimit pas dëgjimit të këngës.

Puna e nxënësve monitorohet dhe ndihmohet.



Përforcimi:

**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit
Pesëvargëshi**

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Skema duhet plotësuar së bashku me nxënësit.

1. Kush?

2. Si është? _____

Camille Saint-Saëns

3. Çfarë bën? _____

4. Një fjalë. _____

5. Një emër ndryshe. _____

Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë atë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e plotësimit të ushtrimit, komentimin dhe paraqitjen vizuale të emocioneve.

Detyrë:

Të shkruajnë për biografinë e Camille Saint-Saëns

Reflektim për rrjetëshen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht...;

Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale recikluese dhe organike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.2, II.5, III.1, III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjej dhe emërtó instrumentet

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Nënizon emrat e instrumenteve në rebus;
- Emerton instrumentet;
- Krijon instrumentin sipas hapave të dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: ngjites, balonë, letër me ngjyra, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Matematikë, Edukatë figurative, Edukim për qytetari demokratike.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Vëzhgo-mendo-plotëso

Ndahen nxënësit në grupe. Hapen librat në faqen 30. Detyrë e secilit grup është që ta plotësojnë ushtrimin e dhënë në libër. Nxënësit duhet të gjejnë në ushtrim emrin e këtyre instrumenteve muzikore: flautin, kitarën, kontrabasin dhe defin.

Puna e tyre vëzhgohet dhe ndihmohet. Secili grup prezanton punën e përfunduar.



Gjej instrumentet

A	V	S	L	K	G
P	I	A	N	O	C
F	O	U	X	N	B
Q	L	S	Y	T	A
X	A	X	C	R	C
F	SH	L	A	A	G
V	L	T	C	B	R
RR	I	A	N	A	D
K	Q	D	U	S	E
K	J	E	I	T	F
X	C	V	B	N	I

PIANO

FLAUTI

KITARA

KONTRABAS

DEFI


30



Emërto instrumentet

Klarineta
Flauti
Harpa
Saksofoni
Perkusionet
Violina

Violonçeli
Pianoja
Defi
Triangli
Lahuta



31

(<https://www.youtube.com/watch?v=H-qxxPlcj1Q>). Nxënësit duhet ta vështrojnë me kujdes videoon me hapat e krijimit të daullës. Secili duhet t'i ketë pranë vetes mjetet e nevojshme (ngjitës, balonë, letër me ngjyra etj.). Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet. Punimet e përfunduara ekspozohen. Ata e krahasojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e emërtimit, nënvizimit dhe krijimit të instrumenteve sipas konstruksioneve të dhëna.

Detyrë:

Të plotësojnë fletoren e punës në faqet 5 dhe 25.

	<i>Reflektojmë përmes rrymedhës së orës mësimore.</i>
--	---



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përpunimi i përbajtjes
Vëzhgo-emërt

Ndahan nxënësit në grupe. Hapen librat në faqen 31. Detyrë e secilit grup është që ta plotësojnë ushtrimin e dhënë në libër. Nxënësit duhet t'i vendosin emrat e instrumenteve muzikore pranë secilit ilustrim.

Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet. Secili grup prezanton punën e përfunduar.

Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin instrumentet e paraqitura në libër. Përpiken të krijojnë ndonjë gjëegjëzë për njëren nga instrumentet e paraqitura në libër. Prezantohet puna e secilit grup.

Pyeten se çka u ka pëlqyer më së shumti në këtë këngë dhe pse.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve
Veprimitari krijuese

Mësuesi/ja shfaq për disa minuta në videoprojektor videoon me hapat e krijimit të daullës.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) si pas imitimit dhe nocionit simbolik...; Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.5.8 2.1. 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Viti i Ri"

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Përgjigjen në pyjet e parashtruar;
- Këndon këngën duke shoqëruar me ndonjë instrument apo lëvizje të trupit; Shkruan mesazhin e Vitisë të Ri.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, CD me këngën nr.19.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë shqipe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Harta e mendimeve

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrithit shkruan "Viti i Ri". Mendimet e nxënësve shkruhen në skemën e mëposhtme. Secilit nxënës në mënyrë individuale i shpërndahet e njëjtë skemë. Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.



Të këndojojmë

Viti i Ri

Shpejt

Dhe bre-dhat që zbar - dhoj - në që ndi-sur me sto - li Dhe
Ne do ta be - so jmë vjen me tē vēr - tet' ku

le - pujt laj - më roj - në se Er - dhi Vit' i Ri
a - kre - pat do ta - ko - jnë o - rēn dy - mbē - dhjet'

C'jan' a - ata gaz - tor' që hi - dhen e lod -
Po a - i pla - kush që e - cén dal - nga

drojn', dal', ūsh' Vi - tin që po vjen' dhu - du - an ta ta - kojn'.
Vi - ti që shkon' dhu - ra - ta do na - ful'.

CD 19 Këngë: "Viti i Ri"

Gjatë këndimit të këngëve, provoni t'i shoqëroni me instrumente ritmike me lëvizje trupore apo ndoshta luani në një instrument melodik.

Pyetje:

- Këndojeni këngën solo dhe në grup.
- Në cilën datë festojmë Vitin e Ri?
- A dini ndonjë këngë tjetër për Vitin e Ri? Cila është ajo?



- Shfrytëzo hapësirën për të shkruar mesazhin dhe urimin për Vitin e Ri.
Kujt do t'ia dhurosh kartolinën?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përputimi i përbajtjes DLTA

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimdhënësi/ja nxënësve u drejton pyetje rreth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD-ja me strofën e parë.

E këndojnë së bashku strofën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyetjet:

Kush zbardhon? Me çfarë stolisen bredhat?

Kështu vazhdohet edhe me strofën e dytë.

Interpretojnë së bashku strofën e parë dhe të dytë.

Pyetjet:

Kush e lajmëroi ardhjen e Vtit të Ri? Kush merr dhurata?

Vazhdojnë me dëgjimin e strofës së tretë.

Nxënësit këndojnë strofën e tretë.

Pastaj këngën e plotë e këndojnë solo dhe në grup duke shoqëruar me ndonjë instrument apo lëvizje të trupit.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve Ese 5 minutëshe

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit që t'i hapin librat në faqen 47. Detyrë e tyre është që të shfrytëzojnë hapësirën për të shkruar mesazhin dhe urimin për Vitin e Ri. Pas përfundimit, nxënësit do të tregojnë se kujt do t'ia dhurojnë kartolinën e përfunduar. Puna e tyre vëzhgohet dhe ndihmohet. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, shoqërimin e këngës me instrument dhe drejtshkrimin e urimit.

Detyrë:

Në pentagram ta paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrim-leximi; Format muzikore

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Dallon elementet themelore muzikore...; Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik...; Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3. II.7, III.2,3,5. V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.5.8 2.1. 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Didaktike: "Dordoleci" - nota Do

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Dallon notën Do te kënga në tekst;
- Përdor notacionin grafik gjatë këndimit;
- Krijon një melodi në bazë të shembullit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD nr.20, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Edukatë figurative, Gjuhë shqipe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Mësojmë duke luajtur

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit një ritëm muzikor që gjendet në linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=dFSPE-EMM88>. Detyrë e nxënësve fillimisht është që ta dëgjojnë. Ata kanë për detyrrë që të tregojnë se cila nga notat e paraqitura është përsëritur më së shumti dhe sa herë. Nxënësit në dyshe i shkëmbijnë përgjigjet. Puna e tyre prezantohet dhe plotësohet.

Nota Do



CD 20 Didaktike: Do "Dordoleci" didaktike

DORDOLECI
(B. Hoxha)

ZANA E MALIT
(B. Hoxha)

48



Dordoleci n'mes t'oborrit,
po i tremb sorrat e Tomorrit.
Kur vjen vera, bëhet vapë,
at'herë sorrat, kthehen prapë.

Do hap lajmë n'katër anë,
kishë parë Vesa një zanë.
Flokë të gjatë, me ngjyrë ar,
n'breg të Drinit, duke i larë.

Nota Do

CD 20 Didaktike: Do "Dordoleci" didaktike

DORDOLECI
(B. Hoxha)

Dordoleci n'mes t'oborrit,
po i tremb sorrat e Tomorrit.
Kur vjen vera, bëhet vapë,
at'herë sorrat, kthehen prapë.

ZANA E MALIT
(B. Hoxha)

Do hap lajmin n'katër anë,
kishte parë Vesa një zanë.
Flokë të gjatë, me ngjyrë ar,
n'breg të Drinit, duke i larë.

48



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përpunimi i përbajtjes
DRTA**

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimdhënësi/ja nxënësve u drejton pyetje rreth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD-ja me strofen e parë. Nxënësit së bashku e këndojnë strofen e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyetjet:

Ku ishte i vendosur dordoleci? Kë i trembte ai?

Kështu vazhdohet edhe me strofen e dytë. Interpretojnë së bashku strofen e parë dhe të dytë.

Pyetjet:

Çfarë ndodh kur vjen vera? Çfarë bëjnë sorrat?

Pastaj këngën e plotë e këndojnë së bashku.

Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit

Veprimitari e drejtar

Hapen librat në faqen 48. Detyrë e nxënësve është që ta rrethojnë notën Do në shembullin e dhënë në libër. Puna e tyre vëzghohet dhe ndihmohet. Pas përfundimit, të ndarë në grupe, provojnë të krijojnë një melodi në tekstin që u ka pëlqyer (nga shembujt e dhënë). Puna e secilit grup prezantohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për gjetjen e notës Do me saktësi në pentagram, interpretimin e këngës dhe saktësinë e përgjigjeve.

Detyrë:

Të plotësojnë fletore punën në faqen 12.

Reflektim për rrjedhien e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore...;

Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht; Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.6, III.2.3, VI.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 7. 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kitara

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Dallon instrumentin gjatë dëgjimit të këngës;
- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Krijon instrumentin e kitarës sipas hapave të dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD, nr. 21, 22, projektor, laptop, fletë A4.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mqedisi, Edukatë figurative, Gjuhë shqipe, Shkaktësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Pema e mendjes

Mësuesi/ja e paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan "Kitara". Mëdimet e nxënësve shkruhen në skemën e mëposhtme. Në mënyrë individuale secilit i shpërndahet e njëjtë skemë. Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë. Disa prej tyre lexohen.



Kitara



CD 21 Rafet Rudi, fragment nga Suita për kitarë

● Të dëgjojmë tingullin e kitarës në veprat e autorëve tanë:



CD 21 Rafet Rudi, fragment nga Suita për kitarë



Të dëgjojmë shembullin 1.



CD 22 Kreshnik Aliçkaj, "Vitorar" - pjesë për kitarë



Të dëgjojmë shembullin 2.

50

- Përpos në muzikën klasike, kitarën mund ta gjejmë edhe në gjinitë e tjera: në muzikë popullore, jazz, blues e deri te muzika rock, pop.



- Ka disa lloje kitarash:
 - kitara klasike,
 - kitara elektrike,
 - kitara bas etj.



- Si quhet personi që luan në kitarë?
- Flisni për ndonjë instrumentist shqiptar, kitarist/e që ju e njihni apo të cilin/en e keni dëgjuar në ndonjë koncert, radio apo TV.
- A keni qenë në ndonjë koncert të kitarës? Nëse po, tregoni për emocionet që keni përjetuar aty.

● Këndi i njohjes:

Kitara është njëri prej instrumenteve më të populuarizuara te ne, e cila ka 6 tela. Atë e gjejmë në të gjitha llojet e muzikës. Kitaristët të njohur në fushën e muzikës klasike për kitarë në Kosovë dhe jashtë saj janë: Ehat Musa, Petrit Çeku etj. Shumë prej kompozitorëve kosovarë kanë shkruar për instrumentin e kitarës.

51



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përpunimi i përbajtjes
DRTA**

Dëgjojnë ndonjë tingull të kitarës në veprat e autorëve tanë dhe të huaj nga CD nr.21 dhe 22. Diskutohet rreth këngëve të dëgjuara. Njihen me llojet e kitarave (klasike, elektrike, bas etj.).

Ndahen nxënësit në grupe. Në secilin grup shpërndahen pyetjet dhe kërkesat e përgatitura nga vetë mësuesi/ja, si p.sh.:

1. Si quhet personi që luan në kitarë?
 2. Flisni për ndonjë instrumentist shqiptar, kitarist/e që ju e njihni apo të cilin/en e keni dëgjuar në ndonjë koncert, radio apo TV.
 3. A keni qenë në ndonjë koncert ku luajnë me kitarë? Nëse po, tregoni për emocionet që keni përjetuar aty.
 4. Nëse jo, përshkruani emocionet tuaja gjatë dëgjimit të dy këngëve në klasë.
- Puna e nxënësve ndihmohet dhe vëzhgohet. Prezanton secili grup. Pyeten se çka u pëlqeu më së shumti në këtë këngë dhe pse.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit
Veprimitari krijuese**

Mësuesi/ja shfaq për disa minuta videon me hapat e krijimit të kitarës, që gjendet në linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=kzjNdhq6NtI>. Nxënësit duhet që të vështrojnë me kujdes videon me hapat e krijimit të kitarës. Secili grup duhet të ketë ngjitet, karton, letra me ngjyra etj. Puna e tyre vëzhgohet dhe ndihmohet. Punimet e përfunduara ekspozoohen dhe krahasohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, dallimin dhe krijimin e instrumentit sipas hapave.

Detyrë:

Të plotësojnë fletore pune në faqen 45.

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Reflektim për rrjetëshën e orës mësimore:

Mësimi | 19

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrim-leximi; Format muzikore

Rezultatet e të nxënëtit të temës:
Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol)) në këngët...;
Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 5. II.7, III.2,3, V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Notat *La* dhe *Si*

Rezultatet e të nxënëtit të orës mësimore:

- Dallon notat *La* dhe *Si*;
- Përgjigjen në pyetjet e parashtruara;
- Argumenton punën e tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: laptop, projektor, CD nr. 23 dhe 28.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diagrami i Venit

Mësuesi/ja secilit nxënës në mënyrë individuale ia shpërndan skemën e mëposhtme. Detyrë e tyre është që të tregojnë dallimet dhe ngjashmëritë mes notës *La* dhe notës *Si*. Prezantohet dhe diskutohet puna e nxënësve.





Nota Si



didaktike

Sim-pa - tin' e kam n'shtë - pi e pér-k'dhel me da-shu - ri sy të
 giel - bér tru - pin gri ēsh't kjo ma - cja i - me a e di ēsh - të
 ma - cja që zgiu - ar rri e th'rret mi - un në gos - ti



- Rretho notën Si, në këngë.

SIMPATIA (B. Hoxha)

Simpatin' e kam n'shtëpi
E pérk'dhel me dashuri.
Sy të gjellbër, trupin gri
Ēsh't kjo macja ime
A e di?
Ēsh't macja që zgjuar rri
E th'rret miun në gosti.

PRANVERA (B. Hoxha)

Si t'vjen Marsi, shkrihet bora,
E çel gonxha, lulebora.
Tash, pranvera me nxitim
i merr hulet në përqafim.



64



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përmbajtjes Dëgjo-mendo-përgjigju

Dëgjohen këngët "Simpatia" dhe "Topi im" me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve rreth përmbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD me këngën e parë. Nxënësit së bashku e këndojnë këngën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyetjet:

Si ishte topi? Pse nuk mund ta zinte?

Kështu vazhdohet edhe me këngën e dytë. I interpretojnë së bashku këngën e parë dhe të dytë.

Pyetjet:

Kë e quante autori simpati? Kë e thërriste në gosti?
Pastaj të dyja këngët i këndojnë së bashku.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit Vëzhgo-analizo-ngaçros

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që te këngët në tekst ta nënvizojnë me ngjyrë të kuqe notën *La* dhe me ngjyrë të kaltër notën *Si*, si dhe ta argumentojnë punën e tyre gjatë prezantimit.

Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, dallimin e notave dhe argumentimin e punës.

Detyrë:

Të plotësojnë fletore pune në faqet 23, 31.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxenit të temës:

Dallon njyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike)...; Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj.; Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.2, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: "Lahuta" - të dëgjojmë: Drinor Zymberi, "Epos"

Rezultatet e të nxenit të orës mësimore:

- Dëgjon me vëmendje këngët;
- Identifikon instrumentet pas dëgjimit të këngëve;
- Përbledh me shkrim karakteristikat e instrumentit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxenësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD nr.24, 25, projektor, laptop, fletë A4.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXENËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxenët
Pema e mendjes

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrëthit shkruan "Lahuta". Mendi met e nxenësve shkruhen në skemën e mëposhtme. Në mënyrë individuale secilit i shpërndahet e njëjtë skemë. Detyrë e nxenësve është që ta plotësojnë. Disa prej tyre lexohen.



Lahuta
 Të dëgjojmë: Drinor Zymberi, "Epos"




CD 24 Drinor Zymberi, "Epos"
 CD 25 Këngë: Niki Mjeda,
 "Një lahutë e një flamur"

Lahuta është instrument popullor me një tel. Tingulli i tij fitohet duke e rrëshqitur harkun, të bërë prej fijeve të kalit, të cilin e gjejnë më shpesh në pjesën e Malësisë së Gjakovës dhe në Rugovë. Me të këndohën këngët tonë epike. Më rrallë e gjejnë në muzikën klasike. Kompozitori i ri, Drinor Zymberi, me sukses ka përdorur këtë instrument në veprën e tij "Epos". Ta dëgjojmë!



Përmend ndonjë instrumentist që luan në këtë instrument.





Lahuta

Të dëgjojmë: Drinor Zymberi, "Epos"




CD 24 Drinor Zymberi, "Epos"

CD 25 Këngë: Niki Mjeda,

"Një Lahutë e një flamur"

Lahuta është instrument popullor me një tel. Tingulli i tij fitohet duke e rrëshqitur harkun, të bërë prej fijeve të kalit, të cilin e gjiejmë në shpesh në pjesën e Malësisë së Gjakovës dhe në Rugovë. Me të këndohen këngët tonë epike. Më rrallë e gjiejmë në muzikën klasike. Kompozitorë i ri, Drinor Zymberi, me sukses e ka përdorur këtë instrument në veprën e tij "Epos". Ta dëgjojmë!



Përmend ndonjë instrumentist që luan në këtë instrument.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Dëgjo-mendo-thuaja grupit

Ndahen nxënësit në katër grupe. Mësuesi/ja e lëshon eposin e Drinor Zymberit përmes projektorit që gjendet në linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=HnYfR2YW8OU>. Nxënësit e dëgjojnë me vëmendje.

Të ndarë në grupe, ata kanë për detyrë të përmen din ndonjë instrumentist që luan në këtë instrument.

Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet, e cila prezantohet nga secili grup.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve Ese përshkruese

Mësuesi/ja kërkon të përshkruajnë me shkrim lahutën sipas formës, materialit, tingujve që lëshon, në cilin grup bën pjesë etj. Pastaj shkrimet e tyre lexohen në grup dhe përcaktojnë njërin nga grupi të paraqesë shkrimin e tyre para grupeve të tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përbledhjes me shkrim dhe identifikimin e instrumenteve gjatë dëgjimit.

Detyrë:

Ta punojnë lahutën prej kartonit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike; Elementet muzikore; Shkrirëm-leximi; Format muzikore

Rezultatet e të nxënëtit të temës:

Dallon elementet themelore muzikore...; Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për performimin dhe krijimin e shprehjes muzikore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 5. II.7, III.2,3,5. V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Notat *Fa* dhe *Re*

Rezultatet e të nxënëtit të orës mësimore:

- Dëgjon me vëmendje këngët;
- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Dallon notat *Fa* dhe *Re*.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD-të 28 dhe 29, fletë A4, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
*Diagrami i Venit***

Mësuesi/ja secilit nxënës në mënyrë individuale ia shpérndan skemën e mëposhtme. Detyrë e nxënësve është që të tregojnë dallimet dhe ngjashmëritë mes notës *Fa* dhe notës *Re*. Prezantohet dhe diskutohet puna e tyre.

Nota Re

CD 29 Didaktike: Re, "Retë"

didaktike

Ret' e ze - za ret' e bar - dha t'kal - tär qie - lli e mbu - lojn'

pas - taj i - kin si pul - bar - dha die - litr dri - tén ia le - shojn'

Rethro notën Re në pentagram.

- Krijoni melodi në bazë të teksteve "Retë" dhe "Shoqja e re", të shkruara nga Burim Hoxha. Pastaj, prezantojni para shokëve dhe shqeve. Së bashku, këndojeti këngën dhe shqejëroni atë me instrumentet që keni. Mund të ndaheni në grupe: grupi i parë e këndon këngën, ndërsa i dyti e shqejëton me instrumentet e ndertura.

- Krijoi një varg të këngës në bazë të teksteve, sipas imagjinatës, dhe prezantojni para shokëve dhe shqeve. Mund të ndaheni në grupe: grupi i parë krijon një varg, kurse grupi i dyti e krijon melodinë në bazë të tekstit që ka bërë grupi i parë.

RETE (B. Hoxha)

Retë e zeza, retë e bardha, t'kaltë qillin e mbulojnë. Pastaj ikin si pulbardha, Diellit dritën ia lëshojnë.

SHOQJA E RE (B. Hoxha)

Po thotë mësuesja "Vini re! Na ka ardhë një çupë e re". Mirë se erdhe në klasën tonë, ti do të bëhesh shoqja jonë.

15



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Dëgjo-mëso-përgjigju

Ndahan nxënësit në katër grupe. Dëgjohen këngët "Faji" dhe "Retë" me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetje rreth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD-ja me këngën e parë.

Nxënësit së bashku e këndojnë këngën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyetjet:

Kush imbetet gjithmonë jetim? Pse nuk e pranon gabimin? Cila notë po dëgjohet? Kështu vazhdohet edhe me këngën e dytë. Interpretojnë së bashku këngën e parë dhe të dytë.

Pyetjet:

Si janë retë? Kujt ia lëshojnë dritën?

Pastaj të dy këngët i këndojnë së bashku.

Cila notë po dëgjohet në këngën e dytë?
Ku është dallimi mes këngës së parë dhe të dytë?



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit Përshkruaj-dallo

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë dy këngët e paraqitura në libër në fletoren e pentagramit, duke i rrethuar me ngjyrë të kuqe notën *Fa* dhe me ngjyrë të kaltër notën *Re*. Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe paraqitjen e drejtë të këngëve në pentagram.

Detyrë:

Të plotësojnë fletore pune në faqet 13 dhe 22.

Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënët të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente...; Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.5 2.1. 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Vendi im"

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Shoqëron këndimin me zë;
- Interpreton këngën me instrument muzikor;
- Krijon një strofë të këngës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD nr.26, instrument muzikor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mqedisi, Gjuhë shqipe, Edukim qytetar.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Pesëvargëshi

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Plotësohet së bashku me nxënësit.

1. Kush? _____ Vendi im
2. Si është? _____
3. Çfarë bën? _____
4. Një fjali. _____
5. Një emër ndryshe. _____

Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë atë. Disa prej tyre lexohen.



Të këndojojmë



CD 26 Muharrem Qena, "Vendi im"

Vendi im

Muzik: Rashit Krasniqi
Teksti: Rashit Krasniqi



I huaj jam!
Dashuri nuk kam.
Për mua nuk lind dielli më.

O vendi im!
Përbuzje ku s'ka, si të lashë e dola në mërgim.

O Sharr, o babai im,
Gërmë - pushimi im,
Adriatiku im,
tash vetëm po ju kujtoj.
[zx]

Fjalorth:
kaçubë - shkurre pa trung, me degë të holla e të dendura që dalin ufe drejt-përdrejt nga rrënjë.

- Tregoni më tepër përvendlin tuaj dhe komentonit vargjet e kësaj këngë.

Cilat janë karakteristikat e vendit tuaj?

Çka e vecon atë?

- Po në këngën e mësuar, cilat janë bukuritë që autori përmend?

CD 27 Lorenc Antoni, "Ç'janë këta krushq" për kor

Këndi i njohjes:

Lorenc Antoni është kompozitor nga Kosova. Ai ka mbledhur një numër të madh të këngëve shqipë. Si njohës i mirë i folklorit tonë, është njëri nga kompozitorët e parë që i ka përpunuar ato me dashuri të madhe. Ta dëgjojmë: "Ç'janë këta krushq", përvendosur përmes projektorit.





TË KËNDÖJMË



CD 26 Muharrem Qena, "Vendi im"

Vendi im

Muzika: Rashit Krasniqi
Teksti: Rashit Krasniqi



I huaj jam!
Dashuri nuk kam.
Për mua nuk lind dielli më.

O vendi im!
Përbujo ku s'ka, si të lashë e dola në mërgim.

O Sharr, o babai im,
Gërmë - pushimi im,
Adriatiku im,
tash vetëm po ju kujtoj.
[zx]

CD 27 Lorenc Antoni, "C'janë këta krushq" për kor

Këndi i njohjes:

Lorenc Antoni është kompozitor nga Kosova. Ai ka mbledhur një numër të madh të këngëve shqipe. Si njohës i mirë i folklorit tonë, është njëri nga kompozitorët e parë që i ka përpumuar ofo me dashuri të madhe. Ta dëgjojmë: "C'janë këta krushq", për kor të përzier.



55

Fjalorth:
kaçubë - shkurre pa trung, me degë të holla e të dendura që dalin tuje drejt përdrejt nga rrënja.

- Tregoni më tepër përvendin tuaj dhe komentonit vargjet e kësaj këngë.
Cilat janë karakteristikat e vendit tuaj?
Çka e veçon atë?
- Po në këngën e mësuar, cilat janë bukuritë që autorit përmend?

Ndahen nxënësit në grupe. Në secilin grup shpërndahen pyetjet e përgatitura nga mësuesi/ja.

Cilat janë karakteristikat e vendit tuaj?

Çka e veçon atë?

Po në këngën e mësuar, cilat janë bukuritë që autorit përmend?

Shto dhe një strofë përvendin tuaj.

Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet. Prezantohet puna e secilit grup.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen përsaktësinë e përgjigjeve dhe mënyrën e interpretimit të këngës dhe krijimin e një strofe.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim përrnjedhjen e orës mësimore:



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:

Përpunimi i përbajtjes

DLTA

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimdhënësi/ja ua drejton pyetje nxënësve rreth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD nr. 26 me strofën e parë. Nxënësit së bashku e këndojnë strofën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyeten:

Kush është i huaj? Për kë nuk lind më dielli?

Kështu vazhdohet edhe me strofën e dytë. I interpretojnë së bashku strofën e parë dhe të dytë.

Shtrohen pyetje të tjera: *Kush e la vendin e vet?*

Ku shkuan? Vazhdojnë me dëgjimin e strofës së tretë. Nxënësit e këndojnë strofën e tretë. Solisti këndon, kurse të tjerët e përcjellin me duartrokutje, lëvizje apo me ndonjë instrument. Tregojnë se çka u ka pëlqyer më së shumti në këtë këngë dhe pse.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit

Diskutim i përbashkët

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente...; Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.5 2.1. 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Fëmijët e Kosovës"

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Shoqëron këndimin me zë;
- Interpreton këngën me instrument muzikor;
- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD nr.10, 11, instrumente, fletë A4


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mqedisi, Gjuhë shqipe, Edukim qytetar.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Pema e mendjes

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan "Fëmijët e Kosovës". Mendimet e nxënësve shkruhen në skemën e mëposhtme. Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë. Disa prej tyre lexohen.



Të këndojojmë

CD 10 "Fëmijët e Kosovës"
CD 11 "Një botë me dashuri"

Fëmijët e Kosovës

Muzika: Argjira Bektashi
Teksti: Argjira Bektashi

Ne fë - mi jët e Ko - so - vës një me - sazh pér bo - tén ke

mi le ta ru - ajm' pa - qen dñe qet' - sin' të pu - nojm' pér ar - dhmë rim'

ne E - vrop' a - po_ A - zi_ i kjo pér ne nuk ka - ren - d'si

i - né mes nesh s'du - het t'ket' ku - fi_ ne je -


mi ve - tém fë mij'_ Të je - tojm' në pa - qe ne Pa da -

llim kom - bi_ a fe - je bash - ka - ngjit - ju Ev -

ro - pës ti_ t'i dhu - rojm' bo - tés da - shu - ri_ të je - ri.

[1.]
[2.]

??? Pyetje:
 - Dëgjo me vëmendje shembujt dhe tregoj për çka bëhet fjalë në tekst.
 - Shpjegoni se si duket bota juaj? Po të kishit fuqit, çka do të kishit ndryshuar?



Fëmijët e Kosovës

Ne fëmijët e Kosovës një mesazh për botën kemi le ta ruajm' paqen dhe qet'sin' të punojm' për ardhmërin'.

Në Evrop' apo Azi kjo për ne nuk ka rënd'si në mes nesh s'duhet t'ket' kufij ne jemi vetëm fëmij'.

Të jetojm' në paqe ne pa dallim kombi a feje bashkangjitu Evropës ti t'i dhurojm' botës dashuri.

Cili do të ishte mesazhi juaj për botën dhe çka do të kishit ndryshuar?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Dëgjo-mëso-përgjigju

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimdhënësi/ja u drejton pyetje nxënësve rreth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD-ja me strofën e parë. Nxënësit së bashku e këndojnë strofën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyeten:

Për kë kishin një mesazh fëmijët? Kë dëshironin që ta ruanin ata? Për kë duhet të punojmë ne?

Kështu vazhdohet edhe me strofën e dytë. Interpretojnë së bashku strofën e parë dhe të dytë. U parashtrohen nxënësve pyetje të tjera:

A duhen dalluar njerëzit për shkak të vendit ku jetojnë? Pse nuk duhet të ketë mes tyre kufij?

Vazhdojnë me dëgjimin e strofës së tretë.

Nxënësit këndojnë strofën e tretë. Pastaj këngën e plotë e këndojnë së bashku, duke përcjellë me ndonjërin nga instrumentet dhe shoqërimin



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës Pyetje-përgjigje

Ndahen nxënësit në grupe. Në secilin grup shpërndahen pyetjet e përgatitura nga mësuesi/ja, si për shembull: Shpjegoni se si duket bota juaj. *Po të kishit fuqi, çka do të kishit ndryshuar? Cili do të ishte mesazhi juaj për botën?*

Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet. Prezantohet puna e secilit grup.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe mënyrën e interpretimit të këngës me një instrument, si dhe shoqërimi me zë i këngës.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente...; Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.4 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Mami, mami"

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Shoqëron këndimin me instrumente të Orfit dhe me duartrokite;
- Këndon këngën sipas notacionit muzikor;
- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, CD nr.30, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mqedisi, Gjuhë shqipe, Edukim qytetar.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Pesëvargëshi

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Skema duhet plotësuar së bashku me nxënësitet.

- Kush? _____ Mami
- Si është? _____
- Çfarë bën? _____
- Një fjali. _____
- Një emër ndryshe. _____

Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë atë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.



të këndojojmë



CD 30 Këngë: "Mami, mami"

Mami, mami

Muzika: Ylli Kalaja
Teksti: Aulon Kalaja



Detyra:

- Shoqëroni këngën me instrumente të Orf-it, me duartrokite.
- Shprehni, me fjalë të thjeshta, përshtypjet për melodinë dhe tekstin e këngës.
- Shkruaj një poezi dhe pastaj shto melodinë.



bt



Të këndojmë



CD 30 Këngë: "Mami, mami"

Mami, mami

Muzika: Ylli Kalaja
Teksti: Auton Kalaja

Music score for 'Mami, mami' with lyrics in two staves. The first staff starts with: Ti je sy - ri që ndrit u - dhën syt ti m'i ke fal' ti je fja - la, fjal' e ém bél. The second staff starts with: Je - tén ti - me ngjall Je nek - ta - ri që thith ble - ta mjalt' që ém bél - son. The third staff starts with: bo tén ve - zu - llon Ma - mi ma - mi ma zem - ra i - me shum' té do. The fourth staff starts with: ma - mi ma - mi ma dor' e leht na le - dha - ton' Ma - mi ma - mi ma ti je. The fifth staff starts with: yll' je hén' e diell Ma - mi ma - mi ma - mi ma veç gë - zi - me ti na sjell.



Detyra:

- Shoqëroni këngën me instrumente të Orf-it, me duartokitje.
- Shprehni, me fjalë të thjeshta, përshtypjet për melodinë dhe tekstin e këngës.
- Shkruej një poezi dhe pastaj shto melodinë.

tt



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Dëgjo-mëso-përgjigju

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimdhënësi/ja u drejton pyetje nxënësve rrëth përbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet CD-ja me strofen e parë. Nxënësit së bashku e këndojnë strofen e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pyetjet:

Cili ishte syri i ndritur? Cila ishte fjala e ëmbël? Kështu vazhdohet edhe me strofen e dytë. Interpretojnë së bashku strofen e parë dhe të dytë

Pyetjet:

Cili ishte nektari që thith bleta? Cilët ishin ylli dhe hëna?

Vazhdojnë me dëgjinin e strofës së tretë. Nxënësit e këndojnë atë.

Këngën e shoqërojnë me instrumente të Orfit dhe me duartrokutje. Pastaj këngën e plotë e këndojnë së bashku.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit

Veprimitari krijuese

Ndahen nxënësit në grupe. Në secilin grup shpërndahen pyetjet e përgatitura nga mësuesi/ja.

Shprehin, me fjalë të thjeshta, përshtypjet për melodinë dhe tekstin e këngës.

Shkruajnë një poezi dhe pastaj shtojnë melodinë.

Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet. Prezantohet puna e secilit grup.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, notacionit muzikor dhe përcjelljes së këngës me instrumentin e Orfit.

Detyrë:

Në pentagram ta paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektime për rrjetërin e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Llojet e muzikës

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.6, III.2,4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.5, 2.1, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Muzika jonë popullore:
“Pranvera filloi me ardhë”

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Dallon meloditë muzikore;
 - Këndon këngën sipas rregullave të këndimit;
 - Përgjigjet në pyetjet e parashtuara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD nr. 17, 18, fletë A4, projektor, laptop


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënët *Pema e mendies*

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrëthit shkruan "Kënga jonë pop-ullore". Mendimet e nxënësve shkruhen në skemën e mëposhtme. Secilit i shpërndahet e njëjtë skemë. Për detyrë e kanë që ta plotësojnë. Disa prej tyre lexohen.



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet
Lënda: Edukatë muzikore
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Këndon dhe interpretion në instrumente (individualisht dhe në grup) sipas imitimit dhe nacionit simbolik (grafik)...; Shoqëron këndimin me zë...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.6, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Prilli piktor"

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga mësuesi/ja;
- Këndon këngën e mësuar individualisht dhe në grup;
- Garon në grup për këndimin më të bukur.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: laptop, projektor, instrumente muzikore, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i përbashkët

Nxënësve u drejtohen pyetjet:
Në cilin muaj jemi tanë?

Cilës stinë i takon muaji prill?


Nxiten nxënësit të pëershkruanjë me fjalë disa cilësi dhe veçori të muajit prill. Në këtë mënyrë nxit kurrestjen dhe interesin për njësinë e re mësimore "Prilli piktor".



Të këndojojmë

Prilli piktor

Muzika: Pranvera Badivuku
Teksti: Mehmedali Hoxha






Të këndojmë

Prilli piktor

Muzika: Pranvera Badivuku
Teksti: Mehmedali Hoxha



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit
Ditari dypjesësh

Në këtë pjesë të orës mësimore këndohet kënga në terti nga secili grup.

Të ndarë në tri grupe, ata garojnë për ritmin më të mirë.

Nxënësit do të plotësojnë në fletë A4 modelin e përgatitur nga mësuesja rreth këngës, autorit të tekstit dhe muzikës.

Detyrë:

Kënga: _____

Muzika: _____

Teksti: _____

Autori i tekstit: _____

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, shqiptimin e drejtë të tekstit, interpretimin ritmik dhe artistik.

Detyrë:

Në pentagram të paraqesin këngën me notat muzikore.

Reflektim për rrjedhien e orës mësimore:



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përpunimi i përmrbajtjes**
Dëgjo-mendo-thuaja grupit

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimdhënësi/ja u drejton pyetje nxënësve rreth përmrbajtjes së këngës. Pastaj lëshohet videoja me pjesën e parë që gjendet në linkun:
<https://slushnikniga.mk/biblioteka-za-deca/albanska-literatura/prilli-piktor/>. Nxënësit së bashku e këndojnë pjesën e parë duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë.

Pastaj mësuesja i pyet nxënësit:

Ku erdhi prilli?

Ku e zuri gjumi prillin?

Kështu vazhdohet edhe me pjesën e dytë. Interpretojnë së bashku pjesën e parë dhe të dytë. Më pas mësuesi/ja i pyet nxënësit:

Kush lulëzoi në kopsht?

Ku cicëruan dallëndyshet?

Në fund nxënësit e dëgjojnë edhe pjesën e tretë.

Pyeten:

Në çka e shëndrrroi natyrën prilli?

Kë gëzoi prilli i bukur?

Pasi të dëgjohet disa herë kënga, mësuesi/ja e këndon pjesën e parë fillimisht vetëm, pastaj kërkon nga nxënësit që t'i bashkëngjiten këndimit. Njëjtë veprohet edhe me pjesën e dytë dhe të tretë, derisa kënga të mësohet bukur dhe në mënyrë artistike.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Krijuesit dhe performuesit

Rezultatet e të nxënët të temës:

Njeh disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjuara muzikore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,4, II,7 ,VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2,1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Profesionet

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Dallon profesionet e këngëtarit, të kompozitorit dhe të dirigjentit;
- Krijon melodinë e vargjeve të dhëna në tekst;
- Interpreton melodinë e krijuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i njohurive paraprake

Mësuesi/ja ka përgatitur materiale për këngëtaren Irma Libohova me këngën "Mësuesja". E paraqet me projektor këngën para klasës. Në bashkëbisedim me nxënësit mësuesi/ja i pyet nëse e njohin këtë këngëtarë. Vihet në pah roli dhe rëndësia e performimit në skenë.

Mësuesi/ja vazhdon edhe me materialin e përgatitur për kompozitoren e njohur shqiptare, Lejla Agolli, për vlerën dhe rëndësinë që ka ajo.

Pastaj shfaq para nxënësve edhe materialin e përgatitur për dirigjentin e njohur shqiptar, Krist Lekaj. Vihen në pah roli dhe rëndësia e dirigjentit.

Profesionet

Instrumentisti



Instrumentisti – me instrumente, Bredh nëpër nota si nëpër shtete,

Dhe përfjeton gurrat – ujëvarën, Kilimanxharon dhe Niagarën,

Instrumentistëve u shkon për dore, Ta bëjnë orkestrën fare madhështore.

Atëherë na ngjet diçka që është pritur, Ngrihet tèrë salla për t'duartrokitur!

Agim Deva



- Numëroni disa instrumente që janë pjesë të orkestrës.

- A keni dëshirë që të luani në ndonjë instrument muzikor? Pse?

- A dëshironi të jeni pjesë e ndonjë orkestre apo kor?

- Tregoni dy apo tre emra të instrumentistëve dhe këngëtarëve që njihni.

Këngëtarët



Këngëtarët janë – këngëtarë, Çdo këngëtar këngën e këndon mbarë, Pa u fjalosur, kë pa e sharë;

Shkëlqejnë këngëtarët si meteorë E kur bashkohen krijojnë një KOR.

Agim Deva

• Tregoni dy apo tre emra të instrumentistëve dhe këngëtarëve që njihni.



Profesionet

Kompozitori



Kompozitori - nuk e ka të lehtë,
Ai notë pas note bën një buqetë,

I mbledh si bleta nëpër nektar
Të gjitha notat botës shpërndarë,

Dhe krijon këngën a simfoninë,
Që shpirtit tim t'ia mbaj' freskinë.

Agim Deva

Dirigjenti



Në skenë dirigjenti qëndron i padiktueshëm,
Por t'gjithë para tij jemi - të dëgjueshëm,

Të gjithë para tij mbajmë - disiplinë,
Ne me kitarë, piano, violinë...

Me një shkop t'vogël, me gisht e kokë,
Na jep sinjale se jemi - shokë...

Dhe me sukses merr fund koncerti,
Meritë t'veçantë ka - dirigjent!

Agim Deva



● Përmendni dy apo tre kompozitorë dhe
dirigjentë të njohur shqiptarë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Veprimitari krijuese

Nxënësit hapin librat dhe në bashkëbisedim me mësuesin/en përgjigjen gojarisht në pyetjet e dhëna në libër.

Recitojnë së bashku me mësuesen vargjet e librit për këngëtarin, kompozitorin dhe dirigjentin. Komentohen vargjet e secilës vjershë.

Mësuesja kërkon nga nxënësit që të krijojnë në grup meloditë e vargjeve:

Grupi i parë melodinë e vjershës "Këngëtarët".

Grupi i dytë melodinë e vjershës "Kompozitori".

Grupi i tretë melodinë e vjershës "Dirigjenti".

Puna e nxënësve monitorohet dhe ndihmohet.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit *Interpretim me instrument*

Secili grup interpreton me ndonjë instrument të Orfit para klasës melodinë e krijuar.

Mësuesi/ja i monitoron nxënësit dhe i ndihmon kur kanë nevojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, krijimin e melodisë dhe interpretimin e melodisë në grup.

Detyrë:

Të gjejnë dhe të shkruajnë emrat e dy këngëtarëve që njohin, dy kompozitorëve dhe dy dirigjentëve.

Reflektim për rrjedhien e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grup) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik)...; Shoqëron këndimin me zë...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.6, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Bicikleta"

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga mësuesja;
- Këndon këngën sipas rregullave të këndimit;
- Përshkruan cilësitet dhe dobitë nga ngasja e bicikletës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, CD nr.15, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjeshti, Njeriu dhe natyra, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për të nxitur kureshtjen rrith njësisë së re mësimore. Pyeten nxënësit se kush e nget automobilin në familjet e tyre. Gjatë bashkëbisedimit nxënësit do të dinë të tregojnë se ata nuk mund të ngasin makina të ndryshme, por dinë ta ngasin bicikletën.

Bashkëbisedojnë se sa e rëndësishme për shëndetin është të ngasësh bicikletën dhe se sa relaksues është ky aktivitet.



Të këndojojmë



CD 15 Këngë: "Bicikleta"


Bicikleta

Muzika: Memli Kelmendi
Teksti: Xh. Kelmendi

Moderato



36



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes *Dëgjo-mëso-këndo*

Nxënësit e dëgjojnë këngën përmes CD-së disa herë. Duke e dëgjuar disa herë do ta përjetojnë atë dhe do të bëjnë lëvizje të ndryshme e nganjëherë do ta përcjellin edhe me duartrokite.


Kënga ndahet në pjesë. Çdo pjesë e re këndohet fillimisht nga mësuesja e më pas i fton nxënësit të këndojnë së bashku.

Për ta bërë më atraktive orën, nxënësit udhëzohen që gjatë këndimit të bëjnë lëvizje me këmbë, sikur po ngasin bicikletën.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit *Harta e mendimeve*

Mësuesi/ja e paraqet përmes projektorit materialin e përgatitur. Detyrë e nxënësve është që të tregojnë cilësitet e dobitë e bicikletës. Mendimet e tyre shkruhen në skemën e përgatitur në projektor. Secilit i shpërndahet detyra në fletë A4, të cilën duhet ta plotësojnë. Nga secili grup do të lexohet nga një detyrë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shqiptimin e drejtë të tekstit, këndimin e saktë intonativ dhe interpretimin artistik.

Detyrë:

Nxiten nxënësit të shkruajnë një poezi të shkurtër për bicikletën dhe të krijojnë një melodi.

	<p><i>Reflektim për rrjetëhën e orës mësimore:</i></p> <hr/> <hr/> <hr/>
--	--

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Krijuesit dhe performuesit

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Njeh disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjuara muzikore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,4, II,7 ,VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2,1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të dëgjojmë: "Simfonia e 5-të e L.V. Beethoven-it"

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Dallon veprën artistike të Beethoven-it;
- Interpreton vlerat e notave, tingujt e shkurtër dhe të gjatë;
- Plotëson rubrikën *Përgjigju* në tekstin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, CD nr.31.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja ka përgatitur materialin me veprën e njohur të Beethoven-it "Simfonia e 5-të", të cilën e shfaq para nxënësve me projektor. Kërkohet që të përgjigjen në disa kërkesa: *Cila është kjo vepër? E kujt është kjo vepër?* I numërojnë disa krijues apo performues që kanë dëgjuar.

Mësuesi/ja do t'u flasë për jetën dhe veprën e Beethoven-it.




Të dëgjojmë:



CD 31 Beethoven: Simfonia e 5-të

Simfonia e 5-të e L.V. Beethoven-it



Dëgjo dhe përcill ritmin & dinamikën!



● Bashkë do të dëgjojmë Simfoninë e 5-të të kompozitorit L. V. Beethoveen.

Në grafikën që ju shihni do të vëreni lehtë vlerat e notave. Do të vëreni tingujt e shkurtër dhe të gjatë. Po ashtu, duke përcjellë grafikën me dëgjim, do ta kuptoni edhe rëndësinë e dinamikës.

68



Beethoven-i është një nga kompozitorët më të njohur botërorë. Simfonia e tij e 5-të njihet në gjithë botën, andaj bashkërisht do ta dëgjojmë këtë vepër, mirépo këtë herë duke e përcjellë grafikën në libër. Në këtë formë do ta shohim vizualisht se si Beethoven-i ka përdorur ritmin dhe melodinë.

69



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përmbajtjes *Dëgjo-përcjell-interpreto*

Nxënësit udhëzohen që të përcjellin ritmin dhe dinamikën duke u bazuar në grafikun e paraqitur në libër. Aty i vërejnë vlerat e notave, tingujt e shkurtër dhe të gjatë. Grafiku në libër i ndihmon nxënësit të shohin më mirë vizualisht se si Beethoven-i ka ndërtuar ritmin dhe melodinë.

Nxënësit i interpretojnë vlerat e notave, si tingullin e shkurtër dhe tingullin e gjatë përmes duartrokiteve apo ndonjë instrumenti.

Pastaj përgjigjen në pyetjet:

Si u nditet gjatë interpretimit të vlerave të notave?

Cilat ishin emocionet tuaja gjatë interpretimit?

Puna e nxënësve monitorohet dhe ndihmohet.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve *Mendo-puno-thuaja grupit*

Nxënësit për të provuar veten për njohuritë e fituara do të plotësojnë rubrikën “Përgjigjuni”, të dhënë në tekstu në faqen 30. Varësisht prej kohës, nxënësit do të lexojnë përgjigjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, njohjen e veprës së Beethoven-it dhe interpretimin e ritmit dhe melodisë.

Detyrë:

Në faqen 70 në librin bazë të gjejnë emrin e kompozitorit të njohur shqiptar.

Reflektim për rrjedhien e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Llojet e muzikës

Rezultatet e të nxënët të temës:

Lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri, përmes dëgjimit muzikor (p.sh. muzikë për vallëzim, muzikë për film, teatër, muzikë për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,3.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Muzeu, teatri, salla koncentrale dhe galeria

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Merr pjesë në bashkëbisedim;
- Dallon muzikën që shfaqen në institucionet artistike;
- Prezanton punën para klasës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjeshti, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët
Diskutim i përbashkët

Mësuesja bashkëbisedon me nxënësit dhe i pyet ata se çfarë bëjnë në kohën e lirë. Gjatë bashkëbisedimit i pyet nxënësit se a kanë vizituar ndonjëherë ndonjë muze, teatër, galeri apo sallë koncertale. Përgjigjen disa nxënës në mënyrë që të dëgjohen sa më shumë përvaja dhe përfjetime.

Muzeu dhe teatri



Muzeu është institucion ku eksponohen objekte të rëndësishme të artit, të shkencës e të kulturës; me vlerë të madhe për një popull.



Teatri është vendi ku aktorët jepin shfaqje teatrale, përderisa teatër të operës quajmë ndërtesën ku zhvillohet një shfaqje operistike, në të cilën këndohet/aktrohet me përcjellje të orkestrës.

Salla koncertale dhe galeria



Salla koncertale është ndërtesa ku zhvillohen koncertet. Ka lloje të ndryshme të sallave koncertale: për orkestër, salla (ose Teatri), për opera etj.



Galeria është ndërtesa ku ekspozohen veprat e artit figurativ (pikturat, skulpturat etj.).

B



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Të nxënët në bashkëpunim

Meqenëse nxënësit kanë njohuri paraprake për institucionet kulturore, mësuesi/ja u ndan nxënësve detyrat në grupe dhe secili grup do të lexojë në tekstin përdetyrën e dhënë, në mënyrë që nxënësit të përshkruajnë se çka dinë dhe çfarë përshtypjesh kanë për secilën nga këto institucionet kulturore dhe cilat lloje të muzikës i karakterizojnë ato.

Nxënësit ndahen në katër grupe dhe u shpërndahan fletët A4 me kërkesën e përgatitur për secilin grup:

Grupi I - Muzeu;

Grupi II - Teatri;

Grupi III - Salla koncertale;

Grupi IV - Galeria.

Skema e përgatitur në fletë A4 duket kështu:

Muzeu është...

Muzeun e kam vizituar me...

Përshtypjet e mia për muzeun janë...

Njëjtë punohet për tri institucionet tjera.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Diskutim i përbashkët

Secili grup e prezanton punën para klasës. Diskutohet dhe analizohet puna e secilit grup.

Mësuesi/ja për të përmbledhur përbajtjen e njësisë mësimore shfaq në projektor materialin e përgatitur për muzeun e Kosovës, muzikën që shfaqet në Teatrin Kombëtar, muzikën në sallën koncertale dhe galerinë e arteve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, punën në grup dhe bashkëpunimin.

Detyrë:

Të shkruajnë për përfjetimet e tyre në njëren nga institucionet që mësuan.



Reflektim për rrjedhien e orës mësimore:

Përmësuesin/en

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Llojet e muzikës

Rezultatet e të nxënët të temës:

Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor...; Për zgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.6, III.2,4, V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5. 2.1,

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llojet e muzikës

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Dallon llojet e muzikës;
- Shkruan emrin e muzikës afër fotografisë që i përket;
- Krahason llojet e muzikës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Harta e koncepteve

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan "Llojet e muzikës". Skema plotësohet nga mendimet e nxënësve. Më pas secilit nxënës i shpërndahet e njëjtë skemë për ta plotësuar atë individualisht. Disa prej tyre lexohen.



Llojet e muzikës

Shkruaj përgjigjen e saktë, duke e identifikuar atë.



Vendos numrat e saktë
në katrorët më poshtë.



1. Popullore



2. Hip-hop



3. Klasike



4. Operë

5. Vals



6. Pop



7. Rock




8. Jazz

74 Të dëgjojmë bashkë shembujt!



Llojet e muzikës

Shkruaj përgjigjen e saktë, duke e identifikuar atë.



74

Të dëgjojmë bashkë shembujt!



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përputimi i përbajtjes
Dëgjo-mendo-thuaja grupit

Mësuesi/ja dhe nxënësit dëgjojnë bashkërisht shembuj të llojeve të ndryshme të muzikës së paraqitur në libër. Pastaj paraqet disa fotografi me llojet e ndryshme të muzikës, nxënësit e identifikojnë llojin e muzikës.

Nxënësit të ndarë në katër grupe i hapin librat në faqen 74 dhe e plotësojnë ushtrimin e paraqitur. Detyrë e tyre është që të vendosin emrin e llojit të muzikës pranë ilustrimit që i takon.

Tregojnë shembuj të llojeve të ndryshme të muzikës që kanë dëgjuar duke bërë dallimin dhe ngashmëritë në mes tyre.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit
Veprimitari në grupe

Nxënësit në grupe kanë për detyrë të bëjnë krahasimin e dy llojeve të ndryshme të muzikës.
Grupi 1: Krahasimin mes muzikës popullore dhe hip-hop;

Grupi 2: Krahasimin mes muzikës klasike dhe operës;

Grupi 3: Krahasimin mes muzikës vals dhe pop;

Grupi 4: Krahasimin mes muzikës rock dhe jazz.

Prezantohet puna e secilit grup.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për plotësimin e ushtrimit me saktësi dhe krahasimin e dy llojeve të muzikës.

Detyrë:

Të shkruajnë për historikun e ndonjë lloji të muzikës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grup) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik)...; Shoqëron këndimin me zë...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.6, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Kënga e planetëve"

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Vrojton përmes projektorit planetët në Sistemin Diellor;
- Këndon këngën sipas rregullave të këndimit;
- Shoqëron këngën me duartrokite apo instrument muzikor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, CD nr.32.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja për të krijuar atmosferë dhe për të nxitur nxënësit rrëth njësisë së re, bisedon me nxënësit rrëth tokës dhe Sistemin Diellor.

Në projektor mësuesi/ja shfaq materialin e përgatitur rrëth planetëve në Sistemin Diellor.

të këndojojmë

KËNGA E PLANETËVE

Tetë planetë silen përreth Diellit
Ylli më të madh kur e shohim qellin
Burim i energjisë, me rreze t'dashurisë
Dielli ne na ngroh dhe na mbush jetën drithë

Merkuri është planeti më i afërt
ditiën është shumë ngrohtë, por ftohtë bëhet
natën në Venerë moti nuk ndryshon
ngrohtë, thatë, frymë, e shiu kurrë nuk pikon

A mund tash t'ia qëllosh, planetin e radhës?
Është Toka, shtëpia joni, ku krejt krijesat bashkëjetojnë
Toka sillet rrëth e rreth si top
Me gjelbërim dhe oqeane, me shumë shoqe edhe shokë

Planeti i radhës, Marsi, është i kuq
Është i madh sa gjysma e Tokës, ka shumë pluhur edhe lloq

Jupiteri si planet është më i madh
Se të kombinohen t'gjithë planetët e tjerë bashkë

Saturnin nëse një ditë ti e sheh
Nga unazat që e janë, shumë lehtë do ta vësh re

Sateli të mund ta janë një planet
27 i ka Urani, dhe kurrë nuk mbetet vetë

Planeti i tetë, Neptuni, është i kaltër
Është planeti më i ftohtë, atmosferën e ka t'akullt.


Kënga e planetëve

nga "Planeti i fémijéve"



CD 32 "Kënga e planetëve"

Muzika: Arbér Salihu
Teksti: Arbér Salihu



- ???
- E dini se cilët janë planetet?
 - Në planetë bën nxeh të apo flohtë?
 - Po ne, në cilin planet jetojmë?
 - A e dini nëse ka jetë në planetët e tjere?



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe mënyrën e interpretimit të këngës.

Detyrë:

Të plotësojnë fletore pune në faqen 7.



Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Krijuesit dhe performuesit

Rezultatet e të nxënët të temës:

Njeh disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjuara muzikore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.7, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2,1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të dëgjojmë: Fahri Beqiri dhe Vinçenc Gjini, Giora Feldman “Let's be happy”

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Paraqet përmes vizatimit emocionet që ndien gjatë dëgjimit të këngëve;
- Liston instrumentet që janë përdorur në të gjitha këngët;
- Përshkruan me fjalë njërin nga kompozitorët e përzgjedhur.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, CD nr. 33, 34, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedis, Njeriu dhe natyra, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Pyetja sjell pyetjen

Çka dini për kompozitorët?

A mund të jeni edhe ju kompozitor? Po, si? Jo, pse?

A njihi ndonjë kompozitor? Po, cili? Jo, pse?

Emrat e kompozitorëve i shkruan në tabelë.



Të dëgjojmë: Fahri Beqiri dhe Vinçenc Gjini



CD 33 Vinçenc Gjini: Variacione për klarinetë dhe piano.



CD 34 Fahri Beqiri: Fragment nga sonata për klarinetë dhe piano.

Fragment nga sonata e kompozitorit Fahri Beqiri

Allegro con brio

Fahri Beqiri

Të mësojmë

KLARINETA

Klarineta është instrument frymor që përdoret në muzikën klasike dhe në atë popullore.

Fahri Beqiri dhe Vinçenc Gjini i takojnë gjeneratës së parë të kompozitorëve tanë profesionistë. Kanë shkruar vepra orkestrale dhe solistike. Kompozimet e tyre për klarinetë pasurojnë thesin tonë muzikor.

T'i dëgjojmë veprat e tyre!

80



Të dëgjojmë: Giora Feldman "Let's be happy"



CD 35 Dëgjim: "Let's be happy"



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes *Lexim i drejtuar*

Nxënësit udhëzohen të lexojnë për këta dy kompozitorë dhe për veprat që kanë krijuar. Po ashtu, mësojmë disa nga karakteristikat e instrumentit të klarinetës dhe për përdorimin e saj. Pasi ata të njihen me këta kompozitorë, me anë të mjeteve teknologjike i dëgjojmë veprat e tyre, si:

Vinçenc Gjini: *Variacione për klarinetë dhe piano.*
Fahri Beqiri: *Fragment nga sonata për klarinetë dhe piano.*

Gjatë dëgjimit nxënësve u shpërndahet nga një fletë e bardhë në mënyrë që të shprehin përmes vizatimit se çfarë po ndiejnë kur dëgjojnë këto vepra. Po ashtu ata arrijnë ta dëgjojnë edhe tingullin e klarinetës dhe karakteristikat e saj që shfaqen në këto vepra.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit *Diskutim i përbashkët*

Shpërndahen fletë A4 me robusin e përgatitur, në të cilin gjenden emrat e kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj. Nxënësit i nënvojijnë emrat e kompozitorëve. Më pas, i diskutojnë ata.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për paraqitjen e emocioneve me anë të vizatimit dhe gjetjen e emrave të kompozitorëve në robus.

Detyrë:

Të dëgjojnë CD 35 "Let's be happy" dhe të shkruajnë përshtypjet e tyre për këngën.

Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike përfëmijë sipas instrukSIONEVE të mësidi hënësit dhe në mënyrë kreative.

Kontributi në rezultatet përkompitetencat kryesore të shkallës: I.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kanoni

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Këndon kanonin në dy grupe sipas imitimit dhe nacionit simbolik (grafik);
- Ritmizon me shuplaka të dorës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, CD nr. 36.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjeshti, Njeriu dhe natyra, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Copëzat e përziera

Mësuesi/ja ka përgatitur definicionin se çka quajmë *kanon* (kanon quajmë këndimin e një pjese muzikore ku zëri i dytë, i tretë etj. ndjekin njëri-tjetrin pas një, dy ose më shumë masave), të cilin e ka ndarë në copëza të përziera. Copëzat ua shpërndan katër grupeve dhe kërkon të garojnë se cili grup do të gjejë i pari dhe do të formojë fjalinë e saktë. Secili anëtar i grupit e lexon fjalinë e formuar, në fund mësuesi/ja e lexon si duhet të jetë fjalia. Titullin e njësisë mësimore e shkruan në tabelë.



CD 36 – Kanon: "Zhapiu"

didaktike
Teksti: Agim Deva

Kanoni

• Nëse melodinë e njëjtë e këndojnë ose e luajnë dy grupe, me q'rasht njëri fillon me vonesë, do ta fitojmë kanonin.

• Ja shembulli më poshtë.
Grupi I fillon lojën, përderisa grupi II fillon të njëjtën melodi nga masa e dytë.

zhapiu

1. 2.

N're-ze die-llit dit' pér dit' dit' pér dit' gjat' gjith' ve-rès u rre-zit

Po na ndo-dhi një cu - di një cu - di zhap zha-pi - u hiç s'u nxi,

Thu se i - shte stru-kur'n'bar stru-kur'n'bar mbet i gjel-bér si më par'.

Kanoni

CD 36 – Kanon: "Zhapiu"

- Nëse melodinë e njëjtë e këndojnë ose e luajnë dy grupe, me q'rust njëri fillon me vonesë, do ta fitojmë kanonin.
- Ja shembulli më poshtë. Grupi I fillon lojën, përderisa grupi II fillon të njëjtën melodi nga masa e dytë.

zhapiu

didaktike
Teksti: Agim Deva

1. 2.

N're-ze die-llit dit' pér dit' dit' pér dit' gjat' gjilh' ve-rés u rre-zit

Po na ndo-dhi një gu-di një gu-di zhab zha-pi-u hiç su-nxi

Thu se i-shte stru-kur'nbar stru-kur'nbar mbet i gjel-bér si më par.

secili prej grupeve duhet ta kenë të qartë ecurinë dhe rrjedhën e këngës. (Njëri grup fillon me vonesë). Puna e nxënësve monitorohet dhe ndihmohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për këndimin e drejtë në grupe dhe përcjelljen me shuplaka të ritmit të këngës.

Detyrë:

Përsërisin ushtrimet në faqen 83 me piano, shuplaka, apo ndonjë instrument që kanë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:
Përpunimi i përbajtjes
Dëgjo-diskuto-analizo**

Analizohet teksti i këngës duke lexuar njëri nga nxënësit.

Për çdo fjalë të re diskutohet në klasë.

Pastaj vazhdojnë me ritmin e këngës, ku në këtë kanon mbizotëron nota katërshe dhe pushimi katersh. Ritmizojnë me shuplaka të dorës dhe një-kohësish lexojnë edhe tekstin.

Dëgjojnë kanonin frazë pas fraze. Pas çdo katër takteve mësuesi/ja përsërit këngën, po ashtu edhe nxënësit bashkëkëndjiten me të njëjtën ritëm. Kësh-tu vazhdojnë deri në përfundim të kanonit.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit
Mësojmë duke dëgjuar**

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja u prezanton nxënësve në projektor këngën e përgatitur, kanonin "Fyelli i bariut", autori i së cilës është Ramadan Sokoli. Nxënësit kanë për detyrë ta dëgjojnë këngën dhe ta mësojnë, por po ashtu të dinë se ku të fillojnë në kanon, pasi kanoni në këtë rast këndohet në dy grupe dhe

secili prej grupeve duhet ta kenë të qartë ecurinë dhe rrjedhën e këngës. (Njëri grup fillon me vonesë).

Reflektime për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Lojërat muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë)

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4,VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2,2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lojë ritmike

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Rezultatet e të nxënët të orës mësimore;
- Ritmizon duke përdorur instrumente ritmike;
- Dallon tingujt e shkurtër nga ata të gjatit;
- Krijon ushtrim ritmik duke përdorur emrin e tij/saj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Lojë me ritëm

Nxënësit lexojnë lojën ritmike të paraqitur në libër. Për secilën figurë krijojnë ritmin duke e përcjellë me duartrokite.

Mësuesi/ja vë në pah se fjala *a-vo-ka-do* përbëhet nga katër nota të shkurtra me gjatësi identike, përderisa fjala *a-ku-llo-re* në vete përmban dy tinguj të shkurtër dhe dy të gjatë.



Lojë ritmike

Të luajmë së bashku!



A - RRA




DAR-DHA




MA - CJA




A - KU - LLO - RE



E - LE - FA - NTI



A - NA - NA - SI



A - VO - KA - DO



Detyrë:

Proponi të luani në ndonjë instrument ritmik. Së pari me emra e më pas vetëm si ushtrim ritmik.

Proponi të krijoni ushtrime, duke përdorur emrat tuaj.

84




Lojë ritmike

Të luajmë së bashku!

Në ushtrimin e parë vërejtëm se rrokjet përbëhen nga tinguj të shkurtër dhe të gjatë. Ta zëmë, fjala a-vo-ka-do përbëhet nga katër nota të shkurtër me gjatësi identike, përderisa fjala a-ku-LLO-RE në vete përbante dy tinguj të shkurtër dhe dy të gjatë.

Në ushtrimin e rradhës ju do të plotësoni dhe të vendosni saktë rrokjet që doni, duke pasur kujdes në ritmin e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e ndarjes në rrokje, për përcjellje me instrumente ritmike etj.

Detyrë:

Të plotësojnë faqen 36 në fletore pune.

<i>Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:</i>



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:

Përpunimi i përbajtjes

Lojë me instrumente

Ritmizohen emrat e nxënësve duke i ndarë në tri nota katërshe. Përmes kësaj loje, nxënësit shkruajnë emrat; varësish nga numri i rrokjeve, i ndajnë në aq pjesë. Ata do të vërejnë se gjatë ndarjes së rrokjeve, nuk do të kenë gjatësi identike, sepse mund të përbëhen nga nota të gjata dhe të shkurtër.

Luajnë në instrument emrin e vet ose e paraqesin edhe vizualisht, pastaj emrin e shokut/shoqes që e ka përballë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës

Ushtro-ritmizo-krijo

Nxënësit e plotësojnë ushtrimin e radhës në libër duke plotësuar dhe vendosur saktë rrokjet që duan, duke pasur kujdes në ritmin e tyre.

Ata kanë për detyrë të gjejnë fjalë dhe të krijojnë ushtrime duke i ndarë fjalët.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: IV

Tema: Instrumentet muzikore

Rezultatet e të nxënët të temës:

Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht...;

Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike (marakas me oriz, misër, dajre të vogla etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.2, II.5, III.1, III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të ndërtojmë instrumente

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Identifikon instrumentet muzikore vizualisht;
- Krijon instrumente sipas hapave të dhënë;
- Krahason punimin e grupit me punimin e grupeve të tjera.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor, laptop, fotografi, materiale ricikluese, oriz, misër, kapak, marakas, karton, letër etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Shkathësi për jetë, Gjuhë shqipe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët
Diskutim i përbashkët

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

Qfarë dini për instrumentet muzikore?

Cilat prej tyre i njihni?

A dini t'i bini ndonjë instrumenti muzikor?

Diskutohet rreth përgjigjeve të tyre.

Të ndërtojmë instrumente

Kastanjeta

Mjetet e nevojshme:
- një pjesë kartuci;
- ngjîsë dhe
- kapak metalik.



Defi (dajrja)

Mjetet e nevojshme:
- pjata;
- letra dhe
- zilet.
Në pjatë letre ngjiten zilet. Sa më shumë zile, tingulli do të dalë më i mirë.



86



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përpunimi i përbajtjes Veprimitari krijuese

Paraqiten përmes fotove instrumente të ndryshme. Nxënësit identifikojnë se cilat instrumente janë paraqitur.

Mësuesi/ja paraqet për pak minuta para nxënësve, të ndarë në katër grupe, videot me hapat e krijimit të deficit dhe kastanjetës.

<https://www.youtube.com/watch?v=9Ux8BN3-Meo>

<https://www.youtube.com/watch?v=NLIi7scvI-uM>

Në secilin grup shpërndahen mjetet e nevojshme për punimin e tyre. Nxënësit duke u bazuar në hapat e parë në video, fillojnë dhe punojnë instrumentet.

Dy grupet e para kanë për detyrë që të punojnë defin, kurse dy grupet e tjera kanë për detyrë që të punojnë kastanjetën.

Nxënësit tregojnë se çfarë u ka pëlqyer më së shumti në punën grupore dhe pse.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës Turi i galerisë

Puna e përfunduar ekspozohet.

Nxënësit i krahasojnë punimet e tyre me grupet e tjera.

Zgjidhet grupi me punimin më të mirë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për punimin e instrumenteve muzikore me karton apo letër, identifikimin dhe krahasimin e instrumentit.

Detyrë:

Të gjejnë dhe të shkruajnë për historikun e deficit dhe të kastanjetës.

Reflektim për rryedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** IV

Tema: Këngët

Rezultatet e të nxënësit të temës:

Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grup) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik)...; Shoqëron këndimin me zë...

Kontributi në rezultatet përkompeten-
cat kryesore të shkallës: I.4, II.6, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së
kurrikulës: 1.1,5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Të këndojojmë: "Lamtumirë"

Rezultatet e të nxënësit të orës mësimore:

- Diskuton pamjet vizuale të shfaqura në projektor;
- Këndon këngën me ritmin e duhur;
- Shoqëron këngën me duartrokite.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, llaptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/ apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra. Edukim për zhvillim të qëndrueshëm

METODOLOGJA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja shfaq në projektor pamje vizuale të nxënësve duke u përshtendetur dhe përqafuar me njëri-tjetrin pasi që po auron fundi i viti shkollor. Pamje të pushimeve verore, fëmijë me familje në mal, det e udhëtime në mjete udhëtimi.

Mësuesja bashkëbisedon me nxënësit përmes pyetjeve se: Ku do t'i kaloni pushimet verore?, Si po ndiheni pasi që erdhi fundi i këtij viti shkollor? Cili është planifikimi juaj gjatë këtij pushim?



të këndojojmë

Këngë: "Lamtumirë"

Lamtumirë

Muzikë: Musa Piperku
Teksti: R. Hoxha

Me butësi



88

Këndi i njohjes:


Musa Piperku është kompozitori ynë i muzikës zbavítse dhe popullore. Këngët e tij përfshijnë, gjithmonë, kanë qenë dhe mbeten shumë të dashura për të gjithë.



Musa Piperku



- Si e keni kaluar këtë vit shkollor?
- Si do t'i kaloni pushimet e verës?
- Cilët janë këngët më të bukurat të këtij viti që do t'i mbani në mend dhe do t'i këndoni?



Lamtumirë

Shkolla ime, erdhë vera,
zilja po thot' të pushojm',
hekurudha për verime
po na fton, na fton të shkojm'.

Klasa ime, ju dritatë,
ju o banka, lamtumir'
lumi, gruri, dielli, deti
fusha, mal po na th'rret.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive: Përputimi i përbajtjes Mësojmë duke dëgjuar

Mësuesi/ja lexon tekstin e këngës dhe bashkë me nxënësit komentojnë çdo strofë. Më pas dëgjohet kënga nga CD-ja disa herë.

Për të mësuar këngën mësuesi/ja këndon këngën vetëm, duke e gërvshëtar me lëvizje të ndryshme, gjeste apo mimikë.

Kënga ndahet në pjesë dhe mësuesi/ja këndon fillimisht vetëm dhe më pas kërkon nga nxënësit që ta shoqerojnë në këndim. Kështu veprohet në secilën pjesë deri në fund.

Pyeten nxënësit:

Si u nditet gjatë këndimit?

Çka ju pëlqeu më së shumti?

Çka do të kishit ndryshuar po të ishit ju autor/e e këngës?



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënëtit

Të nxënët në bashkëpunim

Pasi nxënësit ta kënë mësuar këngën në tërësi, fillon puna në grupe. Grupi i parë ka për detyrë ta këndoje këngën me melodi. Grupi i dytë ta shoqerojë me duartrokositje. Grupi i tretë do të trokasë me laps në bankë. Grupet i ndërrojnë detyrat derisa të realizohet kënga në mënyrë artistike.

Në fund mësuesi/ja flet për kompozitorin Musa Piperku dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në libër pjesën "Këndi i njohjes".

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e interpretimit dhe angazhimin në grup.

Detyrë:

Nxënësit hulumtojnë në internet kompozime të njohura të Musa Piperkut.

Reflektim për rrjetëshen e orës mësimore:





